



Lëvizja e bujqësisë shqiptare drejt bujqësisë së gjelbër, garanci për një ushqim dhe mjedis të shëndetshëm afatgjatë
Prof. Ass. Enver Isufi Faqe 5

10 ditë afat për lejen e ndërtimit - Udhëzimi / Aplikimet për investime në bujqësi që tejkalojnë afatin, skualifikohen
Faqe 4

- Krenaria shqiptare - Ja pse gështenjat e Tropojës janë super të kërkuara në Evropë
Faqe 13

KASH
KESHILLI I AGROBIZNESIT SHQIPTAR

AGROBIZNESI

FED invest
Rr. "Qemal Stafa", P. 9-katësh, Nr. 70, Kati 2, Pazari i ri, Tiranë.
Tel: +355 4 2 251 910 /911
Email: info@fedinvest.al
kontakt@fedinvest.al
www.fedinvest.al

BOTIM I KËSHILLIT TË AGROBIZNESIT SHQIPTAR

Adresa: Rruga "Mine Peza", Pallati 87/3, Hyrja 1, Kati i parë, Tel/ Fax: 2229445
E-mail: infokash@yahoo.com www.kash.org.al

E Premte, 1 Tetor 2021

Viti i shtatëmbëdhjetë i botimit - Nr. 423
Çmimi 125 lekë

E përdryjavshme e pavarur

SKEMA KOMBËTARE DUHET TË MBËSHTESË CERTIFIKIMIN E SHBB-VE GLOBALGAP-I KA RRITUR STANDARDIN E PRODHIMEVE BUJQËSORE, IMPAKT EDHE NË ELEMENTE TË TJERA SOCIALE

Kreu i KASH, Agim Rrapaj: Certifikimi GlobalGAP, kusht në qoftëse ne duam të jemi kampion në Ballkan, për eksportet bujqësore. SHBB-ja që ka marrë certifikatën GlobalGAP, tashmë është në negociata me grupime në Suedi, për të çuar agrumet e prodhimet tona në Suedi, sepse ata erdhën këtu, panë realisht rezultatin që ishte arritur dhe përmes certifikatës tashmë çdo gjë është e mundur. Klima që ne kemi, toka që ne kemi, uji që ne kemi, me këto parametra dhe eksperiencë e fituar, ne na jep mundësinë që edhe në një ekonomi të hapur, sepse ne drejt kësaj do të shkojmë, duam apo nuk duam, ne të kemi mundësi të konkurrojmë.

RISI ALBANIA

Shoqëria e parë e Bashkëpunimit Bujqësor e certifikuar me standardin ndërkombëtar GlobalG.A.P.

GLOBALG.A.P.

Një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC



Dixhitalizimi i bujqësisë, platforma ABA online informacion thelbësor për fermerët dhe bizneset

ABA online, platforma digjitale për zhvillimin e agrobiznesit të fermerëve të vegjël

RisiAlbania
Partner for Growth

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC

Faqe 2

BOTIME TË REJA

"Saga përtej Atlantikut"- Promovohet libri i Shefqet Mekos, reflektim mbi çështjet që përballet shoqëria shqiptare

Faqe 10

TASE GROUP

Adresa: Rruga e Kavajës, Qendra "Kondor", Tiranë;
Cel.: 0672035581; 0684855580

Koyo **bepco** **FAG**

KËNDI I EKSPERTIT

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT TË BUJQËSISË,
SIGURISË USHQIMORE DHE ZHVILLIMIT RURAL

Faqe 11, 12

POLITIKË FISKALE

Braçe kërkon rishikimin e TVSH-së për fermerët: Skema e 2018-s dështoi

Faqe 4

Shoqëria e parë e Bashkëpunimit Bujqësor e certifikuar me standardin ndërkombëtar GlobalG.A.P.

konsumatorët, tregu vendas dhe ai i huaj. “Gjithashtu, tha ai, është një mundësi që në Shqipëri të kemi sa më shumë produkte të certifikuara.”

Në datën 24 Shtator 2021, në Sarandë, u zhvillua ceremonia e dorëzimit të certifikatës GlobalG.A.P. tek Shoqëria e Bashkëpunimit Bujqësor “Agro Isaku”.

“Agro ISAKU” operon në zonën e Finiqit-Sarandë, si kooperativë në kultivimin dhe tregtimin e perimeve e agrumeve të ndryshme. “Agro Isaku” gjatë 2020, vendosi një partneritet me KASH dhe RisiAlbania për të provuar modelin e certifikimit GlobalG.A.P. në grup si një mundësi për të hyrë në tregje më të mira brenda dhe jashtë vendit. RisiAlbania është një projekt inovativ, i mbështetur nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, SDC, në partneritet

me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe që zbatohet nga Helvetas dhe Partnerët Shqipëri. Projekti synon të ofrojë më shumë mundësi punësimi për të rinjtë dhe të rejtat në Shqipëri, nga mosha 15-29 vjeç.

Për të arritur me sukses certifikimin GlobalG.A.P. nuk ka qenë e lehtë. Ekipi i menaxhimit të cilësisë i përbërë nga agronomi, këshillues dhe konsulent i jashtëm kanë punuar ngushtë me grupin e fermerëve brenda dhe jashtë kooperativës për të zbatuar kushtet dhe përmbushur kriteret që kërko-

hen nga ky standard.

Perfaqësuesi i “Agro Isaku”, z. Sinani u shpreh që ky standard na ka ndihmuar për t'i garantuar sigurinë ushqimore në tregun vendas. Në qendër të këtij standardi është siguria ushqimore, kjo pasi analizat e produktit, ujit, tokës, sistemi i gjurmueshmërisë janë kushtet kryesore. “Agro Isaku” ka filluar kontaktet edhe me tregje në eksport konkretisht në Suedi, për eksportin e mandarinave të certifikuara me GlobalG.A.P.

Në takim morën pjesë fermerë, përfaqësues nga

Bashkia Finiq, qarku i Vlorës, Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar dhe RisiAlbania. Kreu i KASH-it, Agim Rrapaj u shpreh që modeli i certifikimit në grup është një mundësi shumë e mirë jo vetëm për eksportuesit, por gjithashtu dhe shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor. Standardet janë e vetmja rrugë për të ecuar përpara.

Gramos Osmani, Menaxher i sektorit të agrobiznesit pranë RisiAlbania thekoi se ky është një model i bashkëpunimit midis fermerëve për të arritur standardet e kërkuara nga





AGRO ISAKU
SH.B.B.



Certifikimi



GLOBALG.A.P.
Rasti i Agrolsaku SH.B.B

24 Shtator 2021, ora 11:00






Mobilizuar nga:



RisiAlbania
Partner for Growth

Një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC

Schweizer Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC

Sinani: Certifikimi GlobalGAP të prezantohet sa më shumë tek fermeri pasi është një iniciativë inovative dhe fitimprurëse

Përfaqësuesi i “Agro Isaku”, Ismail Sinani, në një intervistë për gazetën “Agrobiznesi”, u shpreh: “Me GlobalGAP kemi produkte të sigurta dhe synojmë zgjerimin e tregtimit në hotele, restorante dhe eksporte”

Intervista e plotë:

Cfarë përfitoni ju nga certifikimi GlobalGAP dhe cili ishte roli i RisiAlbania në këtë proces?

Doja ta nisja këtë intervistë me një falenderim për RisiAlbania, veçanërisht Gramos Osmanin si dhe KASH-in, për suportin maksimal gjatë gjithë kësaj periudhe.

vitesh në treg, duke ofruar produkte cilësore mendojmë se konsumatori ka të drejtë të dijë se këto produkte janë të sigurta për shëndetin e tyre. Ne falë këtij projekti arritëm t'i vërtetojmë konsumatorit cilësinë dhe jo vetëm. Synimi ynë është tregtimi i këtyre produkteve në hotelieritë dhe restorantët vendase dhe sig-

ndihmën e tyre do të ishte e pamundur.

A mendoni se produktet tona kanë porteciale për tregjet europiane?

Sigurisht që po, fermerët

tive dhe fitimprurëse.

Cilat janë pritshmëritë tua nga ky projekt?

Sigurisht që ne kemi shumë besim, tashmë kemi në dorë një certifikim ndërkombëtar.



RisiAlbania së bashku me KASH më prezantuan këtë projekt ku do të bëhej i mundur certifikimin GlobalGAP i produkteve tona bujqësore. Ndonëse ne jemi prej shumë

urisht tregu ndërkombëtar. RisiAlbania dhe KASH na kanë ndihmuar si financiarisht ashtu dhe me ekspertët e tyre, pasi kjo punë kërkon një proces të detajuar, ku pa



shqiptarë janë shumë punëtorë dhe japin maksimumin që të kenë produkte të sigurta dhe të mira. Ne kemi një klimë të favorshme gjë e cila na garanton prodhimin përgjatë gjithë vitit për produkte të ndryshme. Unë uroj që ky certifikim të prezantohet sa më shumë tek fermeri pasi është një iniciativë inova-

Kërkesat për produktet tona janë rritur, jemi kontaktuar nga disa klientë potencialë të cilët dëshirojnë produktet tona. Ne tashmë kemi shumë kërkesa edhe për produktet jo të certifikuar, kjo pasi kemi fituar besimin e klientëve. Ne shpresojmë që brenda një viti të jemi pjesë e supermarketeve europiane.

Procesi i Certifikimit GLOBALGAP

Standardi GLOBALGAP është projektuar kryesisht për të lehtësuar shqetësimet e konsumatorëve për mënyrën se si prodhohen lëndët ushqyese në fermë, duke zvogëluar përdorimin e inputeve kimike, duke marrë një qasje të përgjegjshme për shëndetin dhe sigurinë e njerëzve dhe kafshëve, duke minimizuar efektet e dëmshme të punës së fermës në mjedis.

Auditimi i Globalgap synon të krijojë një sistem të krahasimit ndërmjet prodhuesve, furnizuesve dhe shitësve. Benchmarking Globalgap është bërë në nivelin 2. Krahasimet mund të bëhen me skema të barazvlefshme dhe listë kontrolli të Trupave të Lajmëruara.

GLOBALGAP është një organizatë e sektorit privat që përcakton standardet vullnetare për certifikimin e bujqësisë dhe akuakulturës në mbarë botën. Studimet e certifikimit të praktikave të mira bujqësore dhe studimet e certifikimit GLOBALGAP mund të kryhen paralelisht. Organizata ose shoqata prodhuese mund të aplikojë për secilën prej këtyre llojeve të certifikimit ose për të dyja. Certifikata GLOBALGAP është një certifikatë që prodhuesit duan të bëjnë biznes në tregjet ndërkombëtare. Ky dokument kërkohet si parakusht për kompanitë eksportuese që dërgojnë fruta dhe perime të freskëta në vendet e Bashkimit Europian. Nga ana

tjetër, Certifikata e Praktikave të Mira Bujqësore është një dokument që organizatat duan të marrin pjesë në tregjet e brendshme.

Aktivitetet e auditimit kryhen nga organizmat certifikues në përputhje me pikat e kontrollit GLOBALGAP dhe kriteret e përputhshmërisë. Në këto studime inspektohen pikat e kontrollit të përcaktuara dhe përcaktohet niveli i pajtueshmërisë së prodhuesit. Nëse organizata prodhuese ose shoqata prodhuese është konstatuar se ka arritur një nivel adekuat të përshtatshmërisë, organizata prodhuese ose shoqata prodhuese ka të drejtë të marrë një Certifikatë GLOBALGAP.

Megjithatë, nëse përcaktohet se nuk janë në një nivel adekuat të përshtatshmërisë, atëherë prodhuesi që kërkon një certifikatë duhet të jepet një periudhë që nuk i kalon katër javë për të eliminuar moskonformitetet e zbuluara dhe moskonformitetet pritet të eliminohen brenda kësaj periudhe.

Nëse nuk ka pengesa për lëshimin e Certifikatës GLOBALGAP, certifikata lëshohet dhe dorëzohet në organizatën ose shoqatën e prodhuesit. Periudha e vlefshmërisë së Certifikatës GLOBALGAP është një vit. Në fund të kësaj periudhe duhet të kryhen punimet e riinspektimit dhe duhet të lëshohet përsëri Certifikata GLOBALGAP.

INTERVISTA

SKEMA KOMBËTARE TË MBËSHTESË CERTIFIKIMIN ME GOBALGAP TË SHOQËRIVE TË BASHKËPUNIMIT BUJQËSOR (SHBB)

GLOBALGAP-I KA RRITUR STANDARDIN E PRODHIMEVE BUJQËSORE, IMPAKT EDHE NË ELEMENTE TË TJERA SOCIALE

Kreu i KASH, Agim Rrapaj: Certifikimi GlobalGAP, kusht në qoftëse ne duam të jemi kampion në Ballkan, për eksportet bujqësore. SHBB-ja që ka marrë certifikatën GlobalGAP, tashmë është në negociata me grupime në Suedi, për të çuar agrumet e prodhimet tona në Suedi, sepse ata erdhën këtu, panë realisht rezultatin që ishte arritur dhe përmes certifikatës tashmë çdo gjë është e mundur. Klima që ne kemi, toka që ne kemi, uji që ne kemi, me këto parametra dhe eksperiencia e fituar, ne na jep mundësinë që edhe në një ekonomi të hapur, sepse ne drejt kësaj do të shkojmë, duam apo nuk duam, ne të kemi mundësi të konkurrojmë

Kreu i Këshillit të Agrobi-
znesit Shqiptar (KASH), Agim
Rrapaj, në një interviste tele-
vizive, lidhur me çështjen e
sigurisë ushqimore që plotë-
sojnë prodhimet bujqësore
shqiptare, tha se certifikimi
i produkteve me GlobalGap,
është një nga iniciativat më
të rëndësishme që ka ndër-
marrë projekti RisiAlbania në
mbështetje sigurisë ushqimore
dhe të rritjes së eksporteve bu-
jqësore shqiptare. Janë 104
Shoqëri të Bashkëpunimit Bu-
jqësor (SHBB) me të cilat po
punojmë dhe po këmbëngulim
fort, që të ndryshojmë formën
e organizimit në mënyrë të tillë
që të lehtësojmë certifikimin
GlobalGAP dhe certifikatat
e tjera, sepse ulin ndjeshëm
koston e këtyre certifikatave,
në të njëjtën kohë bëhemi të
besueshëm afatgjatë përsa i
përket përdorimit të këtyre
certifikatave.

**Zoti Rrapaj, çfarë lajmesh
të reja vijjnë nga certifikimi i
produkteve tona duke qenë se
një nga sfidat më të mëdha të
produkteve tona është fakti
që nuk dalin dot në tregjet
ndërkombëtare, për shkak se
u mungojnë certifikatat e ga-
rancisë dhe sigurisë?**

Për herë të parë Global-
GAP, me mbështetjen e qeveri-
së zvicerane, të projektit Ri-
siAlbania, ngriti në Shqipëri
grupin teknik, i cili do të për-
faqësojë Shqipërinë përballë
GlobalGAP. Ky grup teknik i
përbërë nga disa institucione
mjaft të rëndësishme, ka si
objekt kryesor të negociojë
me GlobalGAP, në mënyrë të
tillë që Shqipëria të bëhet një
nga vendet, si shumë vende
të tjera, ku një pjesë e mirë e
produkteve të jenë të certifi-
kuara me GlobalGAP. Certi-
fikimi me GlobalGAP ka një
sërë arsyes që ne duhet ta
vlerësojmë në drejtim të nix-
tjes së ekspoteve, punësimit
dhe rritjes së të ardhurave në
ekonominë rurale.

**Zoti Rrapaj, përtej kësaj që
është një lajm shumë pozitiv
për pjesën që duhet të garan-
tohet produkti vendas, pra që
edhe ne të mund të marrim
më të mirën e produkteve që
prodhohen nga toka jonë,
pyetja ime është: A janë të
gatshëm fermerët tanë që të
mund t'i hyjnë një rruge certi-**

**fikimi duke qenë se standardet
e kërkuara janë të tilla që
duhet të investojnë dhe si fil-
lim duhet të kuptojnë se kanë
nevojë të përmirësohen?**

Nuk janë të gatshëm të

shojmë formën e organizimit
në mënyrë të tillë që të lehtë-
sojmë certifikimin GlobalGAP
dhe certifikatat e tjera, sepse
ulin ndjeshëm koston e këtyre
certifikatave, në të njëjtën kohë

Kombëtare mbështet certifi-
kimin GlobalGAP me maksi-
mumin 175 mijë lekë të reja për
subjekt, por jo për grup, jo për
SHBB-të që kanë brenda vetes
së tyre me dhjetëra fermerë që

e përmbledhur do të thotë që
Shqipëria shfrytëzon potencia-
let e saj që ka në agrobiznes,
për të shkuar dhe për të marrë
ato rezultate që përputhen me
atë çka ata investojnë dhe ne do

**sisht rritjes së kostove dhe
reflektimit në çmimin final, të
mund t'i hyjnë kësaj nisme,
sepse kërkon kosto në gjithë
segmentin e vet.**

Nuk janë të mjaftueshme
175 mijë lekë. Për një SHBB
dhe për një klaster janë
fare të pamjaftueshme dhe
të pazbatueshme, prandaj
ne po kërkojmë që krahas
mbështetjes së individit pra
subjekteve të veçanta, të
mbështetet certifikimi në grup.
Ne po e japim provën e parë
që certifikimi në grup është i
mundur, certifikimi i klasterit
është i mundur. Të gjejmë me-
kanizmat që këtë ta shtrijmë
në të gjithë territorin e vendit,
të mos jemi tek 500 hektarshi,
por të shkojmë te 5.000, 10.000
e diçka më tepër sepse i kemi
mundësitë për ta realizuar këtë
dhe unë jam shpresëplotë që
ne këtë mund ta bëjmë, kupto-
het kërkon edhe ndihmën tuaj,
në mënyrë që t'u tregojmë
të gjithëve që është e mun-
dur të bëhet kjo, t'i tregojmë
qeverisë dhe donatorëve që
ka mundësi Shqipëria dhe ka
potenciale. Unë jam besim-
plotë, që ne do ta realizojmë
këtë dhe është ogur shumë i
mirë tashmë edhe ndihma që
jep GlobalGAP-i ndërkombëtar,
duke e futur Shqipërinë
ndër vendet prodhuese me
certifikatë GlobalGAP. Kemi
parasysh që janë 175 vende,
të cilat janë të përfshira në këtë
dhe automatikisht Shqipëria
tashmë është prezente në
këto vende të përparuara që
operojnë përmes certifikatës
GlobalGAP dhe prodhojnë
produkte cilësore. Unë do të
përmend një fakt që tashmë
GlobalGAP-i e ka rritur stan-
dardin, duke futur brenda edhe
elemente të tjera sociale, që
kanë të bëjnë me pagën mini-
male, me sigurimet shoqërore,
kohën e punës së punëtorit, që
kanë të bëjnë me shumë gjëra
të tjera që kanë lidhje ngush-
tësisht me aspektet sociale, që
janë shumë të domosdoshme
për një cilësi afatgjatë e të
qëndrueshme, në mënyrë që ne
të kemi tek konsumatori atë
çka ai pret nga prodhuesi dhe
të mos kemi këtë konfliktin e
përhershëm që kemi, por duhet
t'i kthehemi gjithmonë plagës
sonë, informalitetit, sepse ky
është ai që asgjëson të gjithë

(Vijon në faqen 5)



“

Rrapaj:

Prej 2 vjetësh Skema Kombëtare mbështet certifikimin GlobalGAP me maksimumin 175mijë lekë të reja për subjekt, por jo për grup, jo për SHBB-të që kanë brenda vetes së tyre me dhjetëra fermerë që duhen mbështetur. Tashmë ne po këmbëngulim fort, që kjo të mos ndodhë vetëm për subjektet, por të realizohet edhe për grupime, për klasterin edhe për SHBB-në. Është një kusht, në qoftëse ne duam të jemi kampion për eksportet bujqësore në Ballkan, që i kemi mundësitë për të qenë, kushti është certifikimi.

gjithë fermerët tanë. Ne kemi
tre grupime fermerësh: fermerë
të cilët prodhojnë për konsum
vetiak dhe blegtorinë e tyre,
fermerët të cilët prodhojnë për
konsum vetiak dhe blegtorinë e
tyre por u mbetet një sasi për
treg, kemi dhe fermerë të cilët
janë të angazhuar për tregun
e vendi dhe për eksport krye-
sisht. Ky grupim që është i an-
gazhuar për tregun e vendit dhe
për eksport, ka në përbërjen e
tij njëformë kalsteri, një formë
të përparuar organizimi me
rreth 42 mijë fermerë, ndërsa
pjesa tjetër e fermerëve është
e paformalizuar dhe në këtë
këndvështrim unë them që nuk
jemi të gatshëm. Vetëm këta
42 mijë fermerë mund të ve-
projnë në formë klasteri. Janë
edhe 104 SHBB dhe ne këtu po
këmbëngulim fort, që të ndry-

bëhemi të besueshëm afatgjatë
përsa i përket përdorimit të kë-
tyre certifikatave. Ne jemi opti-
mistë duke parë rezultatin, pasi
SHBB-ja e parë u certifikua,
ngritja e grupit të punës u re-
alizua, në të njëjtën kohë 2 su-
permarkete arritën të tërhiqen
në këtë iniciativë dhe të marrin
produktet tona, pra shqetësimi
i të gjithëve që ne të konsu-
mojmë në tregun e vendit, su-
permarketet tona produkte të
certifikuara është i mundur,
por nuk mund të realizohet me
këtë mbështetje që i jepet aktu-
alisht. Është një mbështetje që
bën qeveria zvicerane përmes
Risisë, por ne kërkojmë një
mbështetje edhe më të madhe
përsa i përket edhe fondeve
që duhen vënë nga buxheti i
shtetit, përmes Skemës Kom-
bëtare. Prej 2 vjetësh Skema

duhen mbështetur. Tashmë ne
po këmbëngulim fort, që kjo të
mos ndodhë vetëm për subjek-
tet, por të realizohet edhe për
grupime, për klasterin edhe
për SHBB-në. Në këtë kënd-
vështrim unë e quaj zgjidhje të
këtij problemi që ka ekzistuar
me kohë. Pa certifikata cilësie
ne nuk kemi cilësi e prodhim
cilësor, pa certifikata cilësie
nuk kemi qëndrueshmëri dhe
nuk kemi eksport në tregjet, të
cilët kanë një vlerë dhe kanë
një çmim të lartë dhe ne i kemi
mundësitë tashmë që të ecim
dhe të shkojmë në këto tregje.
Ne kemi kuota për Bashkimin
Europian, por nuk i realizojmë
këto kuota, pikërisht për ar-
syet e sasisë dhe cilësisë, por
më shumë për arsye të cilë-
sisë, sepse kemi sasi të pakët
me cilësi të mirë. E gjithë kjo

të zgjidhim një ndër elementët
kyç që ka të bëjë me kostot.
Nëqoftëse do të shesim me
çmim të lartë atëherë ne do të
mbulojmë edhe kostot e larta të
produktit, që vijnë për shumë e
shumë arsye të tjera.

**Në fakt unë dua të mbetem
pak tek kostot, duke qenë se
një fermer ose dhe një fermë
e tërë apo SHBB, të mund të
certifikohet, duhet së pari të
investojë më shumë dhe kjo di-
het sepse duhet të arrijë stan-
dardet, nga ana tjetër përfitimi
i kësaj certificate është një
kosto ekstra. U shprehët pak
më herët se mbështetje mar-
rin nga Skemat Kombëtare,
që janë 175 mijë lekë. A janë
të mjaftueshme që të mund të
arrijnë certifikimin SHBB-të
në mënyrë të tillë që pavarë-**

10 ditë afat për lejen e ndërtimit - Udhëzimi/Aplikimet për investime në bujqësi që tejkalojnë afatin, skualifikohen

Sipërmarrjet që kanë aplikuar dhe janë përzgjedhur për tu mbështetur me financim nga fondet e ministrisë së Bujqësisë për masat e investimeve në rastin e ndërtimit/rikonstruksioneve, kanë edhe 10 ditë afat për të siguruar lejen përkatëse të ndërtimit në varësi të investimit sipas legjislacionit në fuqi. Udhëzimi i fundit i Ministrisë së Bujqësisë dhe Ministrisë së Financave, tashmë në fuqi, përcakton se leja duhet të sigurohet para lidhjes së kontratës por jo më vonë se 70 ditë kalendrike nga data e përfundimit të aplikimeve, pra data 24.6.2021. Sipas udhëzimit, dorëzimi i këtij dokumenti mund të bëhet edhe pas afatit të përcaktuar, por jo më vonë se data 30 Shtator 2021.

Po ashtu theksohet se aplikantët që dorëzojnë lejet pas afatit 24 Qershor 2021, por jo me vonë se 30.9.2021, do të renditen pas aplikantëve që kanë dorëzuar lejet brenda

datës 24 Qershor 2021. Mosdorëzimi i lejes së miratuar brenda muajit Shtator përbën

ndërtimi apo rikonstruksioni janë ato për ngritjen ose rikonstruksionin e ambienteve për



kriter skualifikues. Po ashtu, udhëzimi në fjalë detajon se investimi nuk duhet të fillojë para lidhjes së kontratës dhe se dorëzimi i dokumenteve përtej afatit të përcaktuar është kriter skualifikimi, me përjashtim të lejes së ndërtimit.

Masat që kërkojnë leje

veprimtari të turizmit rural nga 6 (gjashtë) deri në 10 (dhjetë) dhoma dhe për investime në agro turizëm kundrejt planit të biznesit ku financohet 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 5- 10 milionë lekë për subjekt.

Mbështetje bujqësisë e turizmit, drejt përfundimit ura në rrugën Fier-Seman

Në Fier po vijon puna në kantierin e ndërtimit të urës

rritjen e sigurisë rrugore. Kryetari i bashkisë Fier, Armando

ritme të larta.

“Falë investimit të qeverisë shqiptare nëpërmjet FSH-ZH-së, me fondet e Bankës Botërore (BB) dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), shumë shpejt do të kemi një urë me parametra bashkëkohore që do i përshtatet investimit që pritet të bëhet në rrugën Fier-Seman/bregdet”, tha Subashi.

Subashi theksoi se “ky investim synon të mbështesë zhvillimin e sektorëve të turizmit, bujqësisë dhe ndërlidhjen rajonale, përmes përmirësimit të aksesit rrugor, si faktorët kryesorë të rritjes ekonomike dhe punësimit”.



Dërmënas, në rrugën Fier-Seman, e cila do të ndikojë në

Subashi ndau foto nga ky kantier ku punimet po vijnë me

Organizata e OKB-së rekruton në Evropë dhe Azinë Qendrore përmes një panairi virtual të karrierës më 7 tetor

Organizata për Ushqimin dhe Bujqësinë e OKB-së (FAO) po kërkon talente të reja entuziaste për të kontribuar në krijimin e një bote pa uri. Më 7 tetor, FAO do të prezantojë mundësi të reja punësimi për profesionistët dhe studentët e rinj gjatë një panairi virtual karriere.

Për rajonin e Evropës dhe Azisë Qendrore, do të paraqiten dy pozicione nën Programin e Profesionistëve të Rinj, duke ofruar një përvojë domethënëse profesionale për të diplomuarit e rinj, si dhe një ekspozim ndaj aktiviteteve të bashkëpunimit ndërkombëtar, duke u mundësuar të rinjtë që aplikojnë në specializimin e tyre teknik dhe kontribuar kundër urisë globale.

"Praktikantët dhe profesionistët e rinj me njohuri në bujqësinë dixhitale ose në qëndrueshmërinë ndaj ndryshimeve klimatike dhe fat-

keqësive mund të aplikojnë për pozicione dyvjeçare pranë FAO-s në Zyrën Rajonale për Evropën dhe Azinë Qendrore, me qendër në Budapest, Hungari," shtoi Stefano Bonezzi, zyrtar administrativ i FAO-s. "Ne besojmë se të gjithë mund të luajnë një rol në dhënien fund të urisë dhe ne nuk mund ta arrijmë këtë qëllim pa ndihmën e të rinjve dhe talenteve të reja."

Në panairin e karrierës virtuale, vizitorët e regjistruar do të mësojnë për FAO-n dhe punën e tij në Evropë dhe Azinë Qendrore, një rajon i gjerë dhe i larmishëm që shtrihet nga Lisbona deri në Vladivostok, nga Rrethi Arktik në Malet Pamir të Azisë Qendrore, si dhe do të bisedojnë me specialistët e burimeve njerëzore dhe punonjësit tjerë të Organizatës.

"Oficeri i ri për qëndrueshmërinë ndaj ndryshimeve klimatike dhe fatkeqësive, dhe

profesionisti i ri në bujqësinë dixhitale, do të kenë një rol kyç në transformimin e sistemeve ushqimore të rajonit për më shumë qëndrueshmëri duke adresuar sfidat e rajonit në fushën e ushqimit dhe bujqësisë", tha Bonezzi.

FAO është një agjenci e specializuar e Kombeve të Bashkuara që udhëheq përpjekjet ndërkombëtare për të mposhtur urinë. Me ekspertizë në të lashtat, blegtorinë, pylltarinë, peshkimin, sigurinë dhe ushqimin e ushqimit, politikën tregtare dhe bujqësore, FAO për Evropën dhe Azinë Qendrore mbikëqyr dhe koordinon aktivitetet e Organizatës në 53 vendet anëtare dhe është anëtare e Organizatës (Bashkimi Evropian) në Rajon.

Regjistrohuni në Panairin e karrierës virtuale i FAO-s dhe vizitoni standin për Evropën dhe Azinë Qendrore!

Zhvillimi i Ekonomisë Blu, Shqipëria kërkon 80 milionë USD borxh tek BB

Qeveria shqiptare ka kërkuar një tjetër hua tek Banka Botërore dhe këtë herë nën një projekt për Zhvillimin e Ekonomisë Blu.

Bëhet fjalë për një shumë 80 milionë dollarë e cila do të merret nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave por do të ketë si zbatues Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit.

Në një përmbledhje të bërë nga qeveria shqiptare thuhet se projekti do të ndihmojë në zbatimin e një qasjeje kombëtare dhe lokale sa i takon Ekonomisë Blu të integruar.

“Ky projekt do të ndihmojë në krijimin e një modeli të integruar të ekonomisë blu në Shqipëri që promovon rritje ekonomike, përmirësim të jetesës si dhe krijon vende pune duke ruajtur shëndetin e ekosistemit detar dhe atij në bregdet. Zona në konsideratë për aktivitetet e projektit është Vlora që ka edhe potencial për të tranzituar nga gri në një zhvillim blu të qëndrueshëm dhe elastik” thuhet në dokument.

Në total parashikohet që projekti të ketë tre komponentë.

I pari është ai për mundësimin e mjedisit për ekonominë blu i cili do të forcojë politikat dhe kapacitetet institucionale për heqjen e kufizimeve detyruese për zhvillimin dhe zgjerimin e BE-së(ekonomisë blu) në nivelin kombëtar. Aktivitetet e propozuara nën këtë komponent përfshijnë asistencë teknike dhe mbështetje për planifikimin hapësor detar, platformat e koordinimit për ekonominë blu, shqyrtimin e planifikimit dhe zbatimit të investimeve, vlerësimi strategjik mjedisor dhe social i planit të zhvillimit të zonës së projektit, sistemi i monitorimit të ndotjes me plastikë, futja e instrumenteve të bazuara në treg për menaxhimin e integruar të mbetjeve të ngurta, modele të zhvillimit të turizmit të qëndrueshëm, peshkimin dhe akuakulturën e qëndrueshme, zhvillimin e kërkimit dhe rritjen e ndërgjegjësimit në nivel kombëtar.

Komponenti i dytë është ai për zhvillimin e BE në zona të zgjedhura dhe do të mbështesë zbatimin e një

modeli të ekonomisë blu në nivel lokal nëpërmjet financimit të investimeve të integruara në tokë, bregdet dhe det. Ky komponent do të mbështesë përgatitjen pjesëmarrjes në programeve të veprimit të ekonomisë blu që promovojnë zhvillimin e infrastrukturës së gjelbër, mbrojtjen e bregdetit nga rrëzimet e erozionit dhe përmbytjet, ruajtjen e biodiversitetit dhe mbrojtjen e tokës dhe peizazheve detare, duke kontrolluar dhe zvogëluar ndotjen. Gjatë fazës së përgatitjes projekti mund të rrisë numrin e zonave të mbrojtura, pyjeve, si dhe lagunave apo ligatinave.

Komponenti i tretë lidhet me zbatimin e projektit dhe do të ketë në fokus ekipin e menaxhimit të projektit, stafin, trajnimet, prokurimet.

Projekti i qeverisë vjen fill pas një studimi të Bankës Botërore i cili u publikua në fund të vitit 2020 dhe që vinte theksin tek përfitimet që mund të kishte nga ekonomia blu duke parë dimensionet nga turizmi tek peshkimi.

Braçe kërkon rishikimin e TVSH-së për fermerët: Skema e 2018-s dështoi

Duke komentuar të dhënat e INSTAT, që treguan në rënie të numrit të krerëve të bagëtive dhe të sasisë të qumështit të prodhuar në vend, deputeti Eriq Braçe fajëson ndryshimet vitit 2018-të të skemës së rimbursimit të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar.

Tre vite më parë, skema e rimbursimit të përpunuesve që produkteve blegtorale ndryshoi me ulje nga 20 për qind në 6 për qind me arsyetimin se agro-përpunuesit abuzonin përmes faturave fiktive dhe se këto para nuk përfundonin në xhepat e fermerëve të thjeshtë, përmes çmimit të blerjes së këtyre produkteve nga ana e grumbulluesve dhe përpunuesve.

Braçe i cilëson sot ato ndryshime si fajtoret kryesore të rënies si të numrit të punonjësve në bujqësi, të numrit të krerëve të bagëtive dhe të sasisë së prodhimit. Ish-zv.kryeministri i referohet faktit se rimbursimi i TVSh-së për produktet e para të importit në këtë sektor është 20 për qind në 20 për qind, ndërsa për prodhimet vendase është vetëm 6 për qind nga 20 për qind.

Sipas tij, lehtësitë e tjera fiskale, si tatim-fitimi zero, nafta pa taksa, TVSh zero për inputet bujqësore dhe tatimi mbi të ardhurat zero nuk po mjaftojnë.

“Përpunuesit humbin para nëse përpunojnë prodhimin vendas. Nuk humbin para të sjellin qumështin nga Maqedonia, kosova, Bosnja, Serbia. Nuk humbin para të sjellin

mishin nga Argjentina, Brazili. Nuk humbin para të sjellin ullirin nga Greqia, të sjellin perime për konservim nga cilido vend i botës. TVSh ka regjimin 20 me 20 për qind në rastet e importit të lëndës së parë për përpunim”, deklaroi Braçe.

Deputeti kërkon që të ndërrhet sa më shpejt dhe ky regjim të ndryshojë.

“Ky problem po plak krahun e punës në bujqësi. Të rinjtë duan të ardhura të përmuajshme dhe ato po bien. Kjo nuk është çështje sindikatash që paguajnë një grusht jo bujqish të derdhen ushqim në rrugë! Sindikata banale kërkon rikthimin e skemës që të rinisë biznesin e faturave false, grabitjes së shtetit e buikut, grabitje që i ka bërë të pasur dhe politikanë, politiqenë në fakt edhe për një arsye, që nuk i hetoi kush në herë të vetme. Kjo është çështje e Partisë Socialiste. Regjimi i TVSh në fshat, prodhim, grumbullim, përpunim, eksport duhet të ndryshojë tani dhe duhet ta ndryshojë PS”, shkruan Braçe.

Vendimi për uljen e rimbursimit të TVSh-së për fermerët u mor në 2018, gjatë diskutimeve të paketës fiskale të vitit 2019.

“TVSH-në e inputeve do ta bëjmë nga 20 në 6% do të ulim po ashtu edhe TVSh e rimbursueshme që kryesisht e kanë përfituar grumbulluesit, që kanë mungesë respekti për skemën pasi nuk e kanë ndarë me fermerët”, deklaronte në atë kohë Kryeministri Edi Rama.

Ndryshimi shkaktoi protestat të fermerëve, ndërsa detyroi grumbulluesit që të zgjidhnin mes dy rrugëve, ose të rrisnin çmimin në treg, ose të ulnin çmimin e blerjes së produkteve bujqësore e blegtorale vendase. Si shembull, për një litër qumësht, të blerë nga fermerët shqiptarë, grumbulluesit rimbursoheshin nga qeveria me 20 lek, por me ndryshimin e bërë, ata përfitonin 14 lekë më pak.

Dështimin e skemës e pranoi në 2020 Bledi Çuçi, në atë kohë ministër i Bujqësisë duke folur gjatë një seance të Komisionit të Ekonomisë së Kuvendit, ku tha se skema e rimbursimit të qumështit ka dëmtuar dhe vijon të dëmtojë fermerët në vend.

“Kjo ishte një masë e domosdoshme dhe që në fakt korrektohte disa gjëra që po ecnin keq, në kuptimin e abuzimit, por për prodhuesit ishte një masë që i penalizoi ata dhe vijon t'i penalizojë. Skema për rimbursimin 20% po kthehej në abuzive dhe sidomos tek sektori i fruta perimeve. Sektori i qumështit është më i ndjeshmi dhe kërkon me të drejtë që të rivendoset edhe një herë jo domosdoshmërisht TVSh e rimbursueshme 20 për qind por të jetë e barabartë me atë që e shesin, pra të jetë 6 për qind në blerje dhe po aq edhe në shitje. Është një instrument i diskutuar edhe në qeveri dhe për pjesën e qumështit ne duhet ta rishikojmë”, sqaroi deklaronte Çuçi.

Dixhitalizimi i bujqësisë, platforma ABA online informacion thelbësor për fermerët dhe bizneset

ABA online, platforma digjitale për zhvillimin e agrobiznesit të fermerëve të vegjël

ral në vendin tonë, pasi synon të jetë një nga instrumentat në mbështetje të objektivave të qeverisë shqiptare për një rritje cilësore të ekonomisë familjare fermere dhe për krijimin e një sektori agrobiznesi efikas”, tha

ipëri”, ne do të fillojmë një promovim mbarëkombëtar të platformës digjitale ABA Online, si një instrument shumë i rëndësishëm që tashmë është bërë një qendër e rëndësishme virtuale për fermerët dhe sipër-

drejtpërdrejtë për fermerët dhe zhvillimin rural në Shqipëri.

“Qendra ABA është platformë e informimit në çdo aspekt që ka nevojë bujqësia sot, mbi tregjet, çmimet, financimin dhe shkëmbimin e eksperiencës, dhe modeleve më të mira të zhvillimit bujqësor, duke u shndëruar në një platformë interaktive edhe rajonale në përgjigje të çdo nevojë që i paraqiten fermerëve sot për zhvillimin e ekonomisë bujqësore”.

“Tregu ABA online pro-

Agjencia Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar (JICA) ka mbështetur rritjen e Përfshirjes Financiare në Shqipëri, nëpërmjet zbatimit të Projektit të Bashkëpunimit Teknik, “Projekti i Përfshirjes Financiare të Familjeve të Vogla në Shqipëri”. Projekti zbatohet në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë të Shqipërisë, dhe ShKK FED invest. Objektivi kryesor i Projektit është përmirësimi i përfshirjes financiare të familjeve të vogla rurale në Shqipëri,



Hudhra.

Ndërsa Kryetarja e Këshillit Drejtues, të FED Invest Zana Konini u shpreh se, “FED invest, që sot numëron rreth 79 748 anëtarë, është në vite partner i besuar dhe promotor i zhvillimit të sipërmarrjes, thuajse në mbarë territorin e vendit, duke i shërbyer një rrethi të gjerë klientele, nga segmentet më të përjashtuara nga aksesimi në financë, deri te SME -të e realizuara”.

“Projektit FiAS, në partneritet me Qeverinë Shqiptare dhe JICA është një nga projektet më të rëndësishëm e të suksesshëm të FED invest. Qëllimi i tij këtij projekti është të nxisë përfshirjen financiare të ekonomive të vogla rurale, duke zhvilluar e ofruar shërbime dhe produkte financiare e jo financiare fleksibël, që i përgjigjen nevojave të fermerëve, nëpërmjet teknologjive të reja”, tha Konini.

Ajo vuri në dukje se Këshilli Drejtues mbështet iniciativën e ABA-s për organizimin e këtij konkursi, i cili, -tha Konini- jo vetëm do të ndikojë në zgjerimin e komunitetit të përdoruesve të ABA online, por do të rrisë edhe vlerën e shërbimeve të ofruara.

Konini nënvizoi punën intensive të stafit të FED invest, Qeverisë Shqiptare dhe konsulentëve të JICA-s, në adoptimin e një qasjeje fleksibël drejt përbushjes së aktiviteteve të projektit gjatë periudhës sfiduese të pandemisë dhe përshtatjen shumë shpejt me komunikimin dhe punën online.

Ndërsa Jiro Takeichi shefi JICA për Ballkanin në fjalën e tij tha se “JICA ka mbështetur rritjen e Përfshirjes Financiare në Shqipëri, përmes zbatimit të Projektit “Përfshirja Financiare e Familjeve të Vogla, në Republikën e Shqipërisë”, ku një nga rezultatet kryesore të Projektit është krijimi i Qendrës së Ndihmës të Biznesit Agrar (Qendra ABA).

“Në dritën e “Projektit të Përfshirjes Financiare të Familjeve të Vogla në Shq-

marrësit e vegjël. Kjo platformë digjitale po shpërndan informacion të dobishëm, edukim mbi tema të ndryshme dhe po ofron një mundësi aksesimi në mjetet thelbësore për lehtësimin e aktiviteteve ekonomike të pronarëve të vegjël”, u shpreh Takeichi.

Sipas tij, kjo platformë tashmë funksionale në internet do të konsolidojë dhe zgjerojë gamën e shërbimeve për sipërmarrësit e vegjël dhe do të shndërrohet në një partner të rëndësishëm të sipërmarrësve të vegjël, si dhe një instrument kryesor për zhvillimin ekonomik dhe rural. Për të siguruar qëndrueshmëri për të ardhmen, vetë Qendra ABA dhe shërbimet që ofron duhet të jenë të një cilësie të lartë dhe konkurruese.

Këshilltari kryesor e projektit FiAS, Hiroko Tanaka, theksoi se “ABA Online ka lindur nga dëshirat dhe ambicia e Projektit për t’i shërbyer nevojave të pronarëve të vegjël në Shqipëri: t’u sigurojë atyre informacionin jetësor mbi tregun agrar dhe teknologjinë e prodhimit agrar, si dhe mundësitë për t’u lidhur dhe takuar me blerësit potencialë. Këto janë informacione jetike për zhvillimin e bizneseve të tyre”.

“Unë jam veçanërisht e inkurajuar këtë mëngjes me dëshmitë e dhëna nga përdoruesit e ABA Online. Secili nga 5 përdoruesit na paraqiti përvojën e tyre të përdorimit të 5 funksioneve kryesore që ne ofrojmë në ABA Online. Shpresojmë shumë që do të ketë gjithnjë e më shumë përdorues si Regi, të cilët mund të na tregojnë për marrëveshjet e suksesshme të lidhura me tregun e ABA Online. Ekipi i Konsulentëve Japonezë do të vazhdojë punën për t’i shërbyer nevojave të fermerëve shqiptarë”, tha ajo.

Ndërsa Behar Gjoni, zv/Drejtor Ekzekutiv i FED Invest dhe menaxher i Qendrës ABA vuri në dukje se “ABA online është një tjetër investim i ri në shërbim dhe në mbështetje të



movon produktet e fermerit dhe afron tregtimin me tregtarët online, pa kosto dhe duke kursyr kohë”, tha ai.

Gjatë këtij takimi përdoruesit e ABA online paraqitën dëshmi mbi përfitimet që kanë përjetuar me ABA online.

duke zhvilluar shërbime të reja financiare dhe jo-financiare që përshtaten shpejt me nevojat e fermerëve. ABA online është “shërbim jofinanciar” i zhvilluar me mbështetjen e Projektit. FED invest është institucioni i parë pionier mikro-financiar

**JICA është një Agjenci e Qeverisë së Japonisë, përgjegjëse për zbatimin e ndihmës dypalëshe përmes Bashkëpunimit Teknik, Kredive ODA (të buta) dhe Ndihmës Grant. Deri më tani në Republikën e Shqipërisë, JICA ka zhvilluar projekte të ndryshme në fushat e mjedisit, zhvillimit të sektorit privat dhe promovimit të shëndetit dhe turizmit.*

***Zyra e Ballkanit e JICA mbulon 6 vende në rajon, Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë, Mal të Zi Maqedoninë e Veriut dhe Serbi.*

GlobalGAP-i ka rritur standardin e prodhimeve bujqësore, impakt edhe në elemente të tjera sociale

(Vijon nga faja 3)

këtë veprimtari që ne kryejmë në vite dhe po vazhdojmë të kryejmë me ndihmën e donatorëve, por edhe me kontributin e vetë investitorëve tanë, të cilët e përkrahin të renë por e kanë të vështirë për ta mbajtur afatgjatë dhe për të përballuar kostot afatgjatë që ka certifikimi dhe gjurmimi në tërësi si proces.

Jemi në fazën kur po diskutohet Open Ballkan, ku po diskutohen marrëveshjet për tregjet e përbashkët dhe shpesh kanë qenë shqetësimet që produktet tona nuk kanë cilësinë dhe nuk mundet dot të konkurrojnë produktet e vendeve të rajonit, kjo për shkak të standardit të cilësisë por edhe për shkak të çmimit e të cilin dalin në treg. Certifikimi i produkteve tona a u jep garanci që të mund të mbijetojnë në tregun e përbashkët ballkanik?

Është një kusht, në qoftëse ne duam të jemi kampion në Ballkan, që i kemi mundësitë për të qenë, kushti është certifikimi. Pa certifikatë ne nuk mund të jemi kampion, është kusht për të shkruar në tregjet europine, është kusht për të shkruar në tregjet skandinave. SHBB-ja që ka marrë certifikatën GlobalGAP, tashmë është në negociatë me grupime në Suedi, për të çuar agrumet e prodhimet tona në Suedi, sepse ata erdhën këtu, panrealisht rezultatit që ishte arritur dhe përmes certifikatës tashmë çdo gjë është e mundur.

Klima që ne kemi, toka që ne kemi, uji që ne kemi, me këto parametra dhe eksperiencën e fituar, ne na jep mundësinë që edhe në një ekonomi të hapur, sepse ne drejt kësaj do të shkojmë, duam apo nuk duam, ne të kemi mundësi të konkurrojmë. Në qoftëse ne do të mbetemi me metodat e vjetra, me fondet e pakta dhe

në Shqipëri i themeluar në 1992. Anëtarësia e FED invest përfshin fermerë, sipërmarrës të vegjël, familje rurale dhe gjysmë-urbane që nuk kanë akses në shërbimet financiare. Si një udhëheqës në ofrimin e zgjidhjeve financiare të përballueshme për popullsinë rurale, FED invest ka një ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin social-ekonomik të Shqipërisë, me mbi 160 mijë kredi dhe gjysmë miliardë euro të injektuara në ekonomi gjatë 28 viteve të ekzistencës së tij. Ekonomia shqiptare bazohet në një segment të madh të fermave dhe bizneseve në pronësi familjare dhe 45% e popullsisë banon në zonat rurale.

Shkalla e përfshirjes financiare në Shqipëri është e ulët. Vetëm 38% e njerëzve mbi pesëmbëdhjetë vjeç kanë llogari bankare në institucionet financiare zyrtare, duke lënë shumë familje pa llogari në institucione financiare formale. Duke pasur parasysh sfondin e mësipërm dhe rëndësinë e çështjes, Qeveria e Shqipërisë, përmes Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, i kërkoj Qeverisë së Japonisë në vitin 2017, të mbështesë një projekt bashkëpunimi teknik që adreson përfshirjen financiare të pronarëve të vegjël ruralë në Shqipëri nga JICA, me fokus zhvillimin e produkteve financiare dhe shërbimet jo financiare të FED invest. Projekti pritet të përmirësojë jetesën e 75 mijë fermerëve të vegjël nëpërmjet rritjes së kapacitetit të FED invest për të përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme shër-

me mbështetjen e pamjaf-tueshme të dhënë në vite, ne nuk do të arrijmë rezultatit dhe nuk mund të shkojmë te konkurrimi me kosto të lirë, por me cilësi të lartë dhe në të njëjtën kohë me sasinë e duhur, prandaj është e domosdoshme që shumica e vënë në dispozicion për Skemën Kombëtare, sidomos tani që IPARD III nuk është akoma në funksion, është e domosdoshme që të tre ose katërfishohet për periudhën që vjen, i ka mundësitë qeveria që jo të japë 6 milion, por të japë 20 milion euro në vit, në mënyrë të tillë, që ne të përqendrohemi fort tek qëndrueshmëria e prodhimit tonë, e aktivitetit tonë me kosto të lirë, me standard cilësie të lartë dhe me marketingun që ne duhet ta përmirësojmë.

Unë shpresoj shumë që ne mundësitë për të konkurruar i kemi, por varet nga puna që do të bëjmë.

BUJQËSI

Bujqësia baza e jetës së shoqërisë

Në çdo shoqëri njerëzore, baza e jetesës është sasia dhe cilësia e produkteve ushqimore.

Ushqimi është burimi i energjisë së njeriut, e kësaj makinerie speciale biologjike-sociale.

Baza e këtij ushqimi janë

Lëvizja e bujqësisë shqiptare drejt bujqësisë së gjelbër, garanci për një ushqim dhe mjedis të shëndetshëm afatgjatë

Prof. Ass. Enver Isufi, Instituti i Bujqësisë Biologjike, Durrës



Prof. Ass. Enver Isufi, Instituti i Bujqësisë Biologjike, Durrës

himët bujqësore dhe kafshët bujqësore.

Sipas peshës që ka bujqësia në një vend të caktuar, mund të quhet vend bujqësor, gjysëm bujqësor dhe vend industrial. Këtë klasifikim e përcaktojnë dy parametra: sipërfaqja që zë bujqësia në sipërfaqen totale të një vendi, dhe kontributi që ajo jep në Produktin e Pergjithshëm Bruto, që e thërrasim GDP. Bazuar në këto elemente, Shqipëria futet tek vendet tipike bujqësore.

Në vendet e industrializuara, me bujqësi meret nga 2 deri në 15 % të popullsisë. Në vendet me drejtim bujqësor, kjo shifër lëviz nga 20-50 % të popullsisë së aftë për punë.

Shqipëria futet në vendet bujqësore, sepse me bujqësi jo vetëm që meren rreth 45 % e fuqisë së aftë për punë, por edhe për faktin se bujqësia kontribon në rreth 20 % të GDP-së sonë kombëtare.

Në Shqipëri vërtet pranohet që me bujqësi merren rreth 45 % e popullsisë, por ky numër është akoma më i madh, nëse përfshijmë edhe fuqinë punëtore, e cila merret indirekt me bujqësinë, siç janë ato që janë përfshirë në marketingun, transportin, shitjen, paketimin, përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, magazinimin, sistemet e ftohjes e deri te univeristetet e bujqësisë dhe shkollat e mesme bujqësore, të cilat përgatisin profesionistët e bujqësisë dhe shkencës bujqësore. Personat e angazhuar në mediat elektronike dhe në ato të shkruara bujqësore, shoqatat jo qeveritare të përfshira në bujqësi dhe veprimtari të ngjashme

me to, të gjithë së bashku janë pjesë e shoqërisë së angazhuar si hallka të zinxhirit të gjatë të

të dyja këto anë të produktit janë njëlloj të domosdoshme. Në kohën kur po jetojmë, ku shkenca dhe teknikat e prodhimit ka ecur shumë përpara, më shumë problem është sigurimi i anës cilësore të produkteve, se sa ajo sasiore.

Pra në vende si Shqipëria, sfida më e vështirë është të sigurojë cilësinë e produkteve bujqësore dhe blegtorale. Arritja e kërkesave të cilësisë janë më të holla, më intelektuale, kërkojnë një infrastrukturë më cilësore.

Cilësia është kaq dinamike, sa që e bën atë aspak të lehtë për t'u arritur.

Cilësia ka një rrugë më të gjatë për t'u realizuar dhe provuar. Cilësi e lartë kërkohet qysh tek fara, toka, uji, cilësia dhe metodat e përdorimit të plehrave, cilësia e produkteve të mbrojtjes së bimeve dhe metodat e mbrojtjes ndaj parazitëve, mjetet e ambalazhimit dhe paketimit, higjiena e mjeteve të transportit dhe të ruajtjes, mjediset e tregëtimit, e deri tek higjiena personale e mijëra e mijëra personave që prekin me duart e tyre produktet e konsumatorëve etj.

Të gjitha këto janë pika që kërkojnë kontroll institucional dhe profesional, për të qenë të sigurtë se produktet që vijnë në tavolinat e konsumatorëve janë të pastra nga mbetjet e dëmshme, të cilat mund të jenë të lokalizuara në sipërfaqe ose në brendësi të masës së produkteve ushqimore me origjinë bujqësore.

3. Bujqësia cilësore, siguron edhe një mjedis cilësorë dhe afatgjatë

Mjedisi i bukur dhe i shëndetshëm, i pastër nga elementët që prishin cilësinë e tillë, është pasojë e një bujqësie me parime ekologjike-mjedisore.

Kur mjedisi me elementet e tij është shëndetshëm me elementet e tilla si, panorama estetike e qytetit, fshtatit, pyllit, cilësia e ujit, tokës, ajrit, parqet, biodiversiteti etj., plotëson kërkesat ekonomike dhe estetike të shoqërisë, kjo shoqëri është e sigurtë dhe e qëndrueshme. Koncepti i qëndrueshmërisë lidhet me ruajtjen e një gjendje positive për një kohë shumë të gjatë, madje jo vetëm për këtë brez, por edhe për brezat e ardhshëm.

Më poshtë do të rreshtojmë disa elemente, të cilët do t'i përshkruajmë në këndvështrimin e një sigurie kombëtare, të një qëndrueshmëria afatgjatë të jetës social ekonomike të vendit. Globalizimi i sotëm i cili karakterizohet nga heqja e pengesave të lëvizjes së njerëzve, ideve dhe mallrave,

e shikon botën gjithnjë e më shumë si një mega-shtet i vetëm.

Kjo filozofi ka të mirat dhe mangësitë e veta. Globalizimi ka përfitimet dhe rreziqet e veta. Ajo që është e vërtetë, është fakti që këtë "lojë të hapur" e ka pranuar edhe Shqipëria.

Është pak a shumë si të pranosh të marrësh pjesë në eliminoret e kampionatit botëror dhe europian të futbollit dhe të mos pranosh të luash me ekipet e mëdha në futboll, por të luash vetëm me ekipet e vogla, sepse vetëm me to kemi mundësi të matemi.

Bujqësia është jo vetëm bazë e ushqimit të popullit, por edhe e sigurisë kombëtare, të vetë pavarësisë reale të saj.

4. Bujqësia cilësore dhe e fuqishme e cila siguron të ardhura financiare, pavarësi financiare të vendit. Forcimin e financave vjen nga tre drejtime kryesore: në paksimin e volumit të produkteve të importuara, në shtimin e shitjeve në vend dhe shtimin e eksportit në vendet e tjera.

5. Bujqësia e fuqishme dhe cilësore, siguron punësim më të gjërë se sa një bujqësia e dobët dhe pa infrastrukturë e nevojshme të kontrollit të cilësisë.

Zinxhiri i punësimeve në një bujqësi të fuqishme, rrit pjesëmarrjen e popullsisë në mirëqenien e kombit. Ky punësim jo vetëm e forcon ekonomikisht Shqipërinë, por e forcon popullsinë edhe nga ana fizike, i jep shoqërisë një dinamikë fizike. E kundërta ndodh në një bujqësi të varfër, ku mungesa e të punësuarve në bujqësi dhe në rrjetin e saj dytësor, dobëson forcën njerëzore të shoqërisë sonë.

Ky dobësim pasohet nga dobësimi i kontributeve të tyre në arsim, sport, shkenca teknike, e deri në forcën ushtarake të vendit.

6. Bujqësia e fortë, rrit forcën integruese të Shqipërisë në radhë të parë në rajon, e pastaj edhe me vendet e tjera europiane, akoma më larg me kufijtë tanë shtetërorë.

Të analizojmë praktikisht forcën që ka bujqësia jonë të integrojë Shqipërinë me vendet Ballkanike.

7. Bujqësia mesdhetarë shqiptare, përparësi ndaj bujqësisë së Ballkanit me klimë kontinentale

Dihet se në Ballkanin Perëndimor, Shqipëria ka klimë mesdhetare, ku produktet dalin në treg një muaj më herët se sa perimet dhe frutat e prod-

huara në vendet e Ballkanit kontinental. Shqipëria edhe në kuadrin e një tregu të integruar Ballkanik, jo vetëm që është një potencial i madh tregu, por as nuk mundet të mbulojë dot këtë treg. Shkurt, Shqipëria Medhetare, ka kaq shumë treg për produktet bujqësore, sa që nuk e furnizon dot me produkte bujqësore dhe blegtorale as Ballkanin kontinental. Pra tregu ynë më i afërt është tregu ballkanik. Fakti që produktet tona bujqësore kanë gjetur tregje edhe në vendet europiane të zhvilluara, kjo tregon se standartet tona aktuale nuk janë pengesë për të konkuruar në tregun rajonal ballkanik.

Nëse Shqipëria bëhet burim për furnizimin e tregut ballkanik, kjo do të rrisë sigurinë kombëtare, do të shtojë rolin e Shqipërisë në rajon dhe në Europë, do të shtojë elementët e paqes, do të investojë më shumë për paqen se sa për luftën.

Pra mendoj se bujqësia ka forcën më të madhe ta përdorë ekonominë si element pajëje. Kur jep dhe merr mallra, sidomos mes vendeve fqinjë, miqësia mes shteteve fqinjë vetëm forcohet.

8. Ndikimi tjetër faktor në integrimin ballkanik dhe europian të Shqipërisë, është edhe zgjerimi ekonomisë së turizmit dhe të agroturimit.

Vitet e fundit, Shqipëria vizitohet nga një numër vizitorësh, më shumë se dy-fishi i vetë popullsisë së Shqipërisë. Vetëm pak vende ka, ku një vend vizitohet nga aq shumë turistë në raport me popullsinë e vendit, siç është Shqipëria. Kur kemi parasysh se ky bum turistësh është një fenomen i vetëm pesë viteve të fundit, ne duhet të përgatitemi që sot, se çfarë do të ndodhë pas pesë dhe dhjetë viteve, kur opinioni i mirë i Shqipërisë do të rritet akoma më tej dhe alternativat për të udhëtuar drejt Shqipërisë do të shtohen (kujtojmë vetëm modernizimin e porteve dhe aeroporteve), të cilët pritet të shtohen këtë dhjetëvjeçar ku kemi hyrë.

Këto miliona turistë, përveç forcimit tonë ekonomik, është edhe një publicitet i madh që i bëhet Shqipërisë. Një vend që ka shumë miq në botë, ka më shumë siguri kombëtare.

Në një pyetësor të realizuar mes turistëve që kanë vizituar në Shqipërinë, si gjërat më e pëlqyera, që ata kanë gjetur në Shqipëri përmendin ushqimin e shijshëm dhe të shëndetshëm si dhe mikpritjen dhe ngrohtësinë e njerëzve. Kjo prirje duhet ruajtur gjatë dhe përgjithmonë.

Një strategji e tillë e forcimit

të bujqësisë cilësore, sidomos është domosdoshme për vendet e vogla si vetë Shqipëria. Shqipëria nuk bën dot presion me sasinë e mallrave dhe çmimet e ulëta, Shqipëria ka në dorë të bëjë presion tregut dhe konsumatorëve, vetëm me cilësinë e lartë të produkteve me shije dhe shëndet.

9. Bujqësia me produktet se saj cilësore lidhet me sigurinë kombëtare edhe në lidhje cilësinë e shëndetit të popullsisë.

Është shkencërisht e vërtetuar se një ushqim cilësor rrit imunitetin ndaj "armiëve" të vetë trupit tonë, të cilat janë sëmundjet e shumta që kërcënojnë shëndetin njerëzor.

Ushqimi i shëndetshëm është baza e shëndetit të shoqërisë. Në rastin e pandemisë së shkaktuar nga Covid 19, "farmacinë" më të madhe e ofroi bujqësia. Ishin agrumet, perimet, çajrat e florës sonë mjeksore, produktet e bletës, të cilët ndihmuan në kufizimin e kësaj sëmundje virusale mes popullsisë së vendit tonë.

Sa më e lartë të jetë cilësia e këtyre produkteve, aq më imun do jetë shëndeti ynë kolektiv. Kjo shton edhe një element tjetër i pavarësisë tonë ekonomike dhe një tjetër garanci për më shumë siguri kombëtare.

Konstatojmë se numri i personave me trup obez në zonat fshatare, është shumë më i vogël se sa ato në zonat qytetare. Pse ndodh kjo?

Ndodh sepse në zonat fshatare ka një ushqim më të freskët dhe një mjedis me ajër më të pastër se sa në zonat qytetare. Këtu futet edhe fakti që në zonat fshatare ka një barazpeshë mes energjive që mer trupi dhe energjisë që harxhon ai. Pra punët në bujqësi nuk lënë vend për deformin fizik të trupit. Pra aktivizimi në punët bujqësore dhe konsumi i produkteve direkt nga fusha, rrit sigurinë fizike, e cila është pjesë e sigurisë kombëtare.

Bujqësia cilësore siguron edhe një mjedis shëndetshëm.

10. Bujqësia cilësore me vetë sipërfaqen e madhe të saj (rreth 700 mijë hektarë) ka një ndikim të madh në mjedisin në përgjithësi. Bujqësia e shëndetshme me sisteme moderne prodhimi, të cilët përdorin inpute miqësore me shëndetin dhe mjedisin, ruan të pastër higjenikisht, tokën, ujin, ajrin, biodiversitetin bimor dhe atë shtazor.

Shënim: Artikulli, pjesa e dytë do të përshkruajë "Rrugët dhe mekanizmat që e çojnë bujqësinë tonë, drejtë konceptit "Bujqësi e Gjelbër" e varur sa më pak nga importet".

(Vijon në numrin pasardhës)

TREGTI

Importet “mposhtin” prodhimin vendas në shumë sektorë

Pesha e industrisë agroushqimore në prodhimin e brendshëm bruto është më e ulët se në vitin 1996. Taksat, kostot e larta të transportit të lëndëve të para dhe mungesa e subvencioneve nga shteti konsiderohen faktorët kryesorë që disa industri të prodhimit agroindustrial kanë ulur peshën në treg, në raport me importet. Po çfarë zgjidhje rekomandojnë shoqatat e prodhimit dhe të eksporteve? Në cilët sektorë po përcaktohen hapat konkretë që do të merren për të ardhmen nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural?

Prodhimi i birrës vendase

Pesha e prodhimit të birrës vendase në treg në periudhën 2013-2020, sipas të dhënave të doganave, është ulur, në 47.8% në 2020-n, nga rreth 60% në 2015-n, sipas të dhënave nga akciza të raportuara nga Ministria e Financave.



Kryetari i këshillit drejtues të birrës “Tirana”, Luan Bregasi thotë se dy janë arsytet e rënies së peshës së prodhimit vendas – kostot e shtuara për shkak të çmimit të lartë të energjisë elektrike, akcizës, ujit etj., si dhe konkurrenca e pandershme nga ndryshimet fiskale të miratuara në 2012 nga qeveria “Berisha”, që nisën zbatimin në 2013.

“Nga viti 2013, dy kompani importuese të birrës shfrytëzuan në rrugë joligjore dispozitën e ligjit të akcizës, e rekomanduar nga Komisioni Europian dhe e përshtatur në legjislacionin shqiptar, që përcaktonte se industritë e huaja të birrës, që prodhojnë nën 200 mijë hektolitra, për importin të paguanin akcizë 15 lekë/litrë nga 30 lekë/litrë.

Përgjysmimi i akcizës rezultoi se po shfrytëzohej në mënyrë të pandershme prej dy kompanive importuese, pasi kapacitetet prodhuese të fabrikave të huaja ishin mbi 200 mijë hektolitra. Kjo do të thotë që në rrugë joligjore u favorizuan disa kompani, duke paguar gjysmën e akcizës. Me kërkesë të Shoqatës të Prodhuësve të Birrës Vendase, shkeljet ligjore u korrigjuan në 2019, por këto kompani fituan shumë epërsi në treg dhe vazhdonjë të mbizotërojnë.

Arsyeja tjetër që po favorizon shitjet birrës së importit janë kostot shumë herë më të larta të prodhimit të industrisë vendase, krahasuar me atë të importit të një produkti të ambalazhuar. Kostot e prodhimit vendas janë rënduar për shkak të çmimit të shtrenjtë të energjisë elektrike, të ujit, kostos së lartë për parapagimin e akcizës dhe pullës fiskale”, pohoi më herët Luan Bregasi.

Rritja e importeve eklipson prodhimin vendas të verës

Sipas të dhënave të Doganave, vera e importit zë 84% të produktit të konsumuar në 2020. Tendenda ishte e njëjtë edhe në vitin 2019. Nga totali

i verës së konsumuar, 79% e zë importi.



Tendenda e importeve nga 2015 deri në 2019 është në rritje. Prania në treg e shumë markave të huaja të verërave dhe abuzimet me shitjen e tyre, po lënë në hije markat shqiptare, shprehet drejtuesi i fermës “Uka”. Sipas tij, në këto kushte është i nevojshëm zbatimi i një rregullatori nga shteti, në mbrojtje të prodhimit vendas.

“Një subjekt që prodhon verë prej 15 vitesh e ka të vështirë ta shesë atë në Shqipëri, pasi tregu dominohet nga importet. Në anën tjetër, në tregun e shitjes së verës së importit, ndodhin abuzime, të cilat duhet të kontrollohen nga shteti, pasi po lënë në hije prodhimin vendas. Tarifat doganore për importin janë shumë të ulëta, ndërsa procedurat për eksport janë të shumta, duke përfshirë edhe koston e lartë të marketingut.

Drejtori i përgjithshëm i kantinës së pijeve “Gjergj Kastrioti Skënderbeu”, Denis Zhilla, theksoi se në tregun aktual, krahas prodhimit vendas të verës janë më shumë të pranishme verërat e importit, sidomos ato të Italisë, Francës, të Malit të Zi, Maqedonisë së Veriut e Kosovës etj. Sipas tij, zhvillimi i kësaj industrie në vend kërkon vëmendje të veçantë dhe paraqitet mjaft kompleks, për sa u përket varieteteve të rrushit të prodhuar në vreshtat shqiptare dhe gamës së pijeve, sipas varieteteve të hedhura në treg me brand name

të ndryshme.

“Zhvillimi i industrisë së prodhimit të verës ushqimore synon plotësimin e shijes konsumatore me prodhime vendi. Si e tillë, kjo industri merr në konsideratë vreshtat, prodhuesit vendas (kantinat dhe fabrika), ofruesit e ambalazhimit dhe tregtarët lokalë.

Ndërkohë faktor shumë i rëndësishëm në treg mbeten, pa dyshim, importuesit e këtyre produkteve nga Italia, Franca, SHBA, Greqia dhe Kili, por dhe nga vendet e Ballkanit”, – pohon drejtori i përgjithshëm i

kantinës së pijeve “Gjergj Kastrioti Skënderbeu”.

Rriten eksportet e fruta-perimeve dhe ujit

Deri në fund të vitit 2019, në tërësi, prodhimi industrial në Shqipëri, sipas përfaqësuesit të Shoqatës së Prodhuësve, Arben Shkodra, shënoi tendencë rritëse të eksporteve, me përjashtim të pijeve alkoolike.

“Rritja ishte te fruta-perimet, bimët mjekësore dhe kjo për shkak të zbatimit për dy herë radhazi të skemës së IPARD te fruta-perimet. Skema u krijoi mundësi prodhuesve që të kultivonin më shumë produkte, të rrisnin likuiditetin, kapacitetin e magazinimit të fruta-perimeve, të përpunimit



dhe eksporteve.

Sektor i favorizohet edhe nga prania e dy cikleve të prodhimit në Shqipëri, si: pranverë-verëvjeshtë dhe verë-vjeshtë, duke kapur një cikël prodhimi nga

marshi deri në nëntor, ndërsa vendet e tjera ballkanike nuk dalin dot me dy cikle prodhimi. Viti 2020 pati stanjacion për këtë sektor, por vazhdimi i IPARD dha mundësinë që ky sektor të kishte ecuri më të mirë se të tjerët në industrinë e përpunimit. Kërkesa e fortë, si dhe masat që u morën nga IPARD ia vlejtn.

Te pijet alkoolike dhe birrat nuk shfaqet e njëjta tendencë, sepse ato vuajtën problemin me tregtimin e brendshëm dhe të jashtëm, çka do të thotë që magazinat ishin plot, lokalet ishin bosh dhe nuk kishin tërheqje malli. Sektori i verës dhe birrës ankohet shumë, por edhe prodhuesit e tjerë të pijeve alkoolike, pasi masat kufizuese i penguan që të kishin ecuri si ushqimi”, thotë Shkodra.

Ecure pozitive tek eksportet, sipas Shoqatës së Eksportuesve ka pasur edhe për sektorin e ujit, çimentos dhe hekurit, ndërsa prodhimi i metaleve me ngjyra pritet të kthehet në normalitet në 2022. “Uji dhe lëngjet e frutave patën tendencë pozitive, sektori i ujit ka rritur eksportet në tregjet e Arabisë, Lindjes së Mesme dhe Europë.

Si mund të rritet prodhimi, çfarë këshillojnë shoqatat

Për përfaqësuesin e Shoqatës së Prodhuësve Shqiptarë, z. Arben Shkodra aktualisht prodhuesit vendas po vuajnë tre problematika, si: mungesën e likuiditetit, mospasjen dhe largimin e punonjësve të kualifikuar, dhe rritjen e lartë të tarifave të transportit ndërkombëtar. Shoqata e Prodhuësve rekomandon për secilën prej tyre një zgjidhje konkrete.

“Së pari, për zgjidhjen e këtyre problemeve duhet të zhvillohet dialog mes qeverisë

menaxhohet nga institucionet ndërkombëtare, si BERZH apo Banka Botërore. Por duhet të jetë një bankë zhvillimore, që të garantojë, si instrumentet e garancive sovraane dhe fondet e grandeve për SME-të, bizneset e grave, start-up-eve dhe kompanive.

Për kualifikimin e punonjësve është i domosdoshëm që, në të ardhmen, të kryhet një rimodelim i arsimit profesional, i cili nuk duhet të jetë më shtetëror, por të jenë private sektoriale. Nga biznesi duhet të përcaktohet si duhet të jetë korniza e kualifikimeve, çfarë kërkesash duhet të plotësohen në të ardhmen, si dhe të vazhdohet për arsimimin e punëtorëve të kualifikuar, pasi edhe ata që janë po largohen nga Shqipëria. Për zgjidhjen e problemit të transportit duhet të lehtësohen taksat te sektori i përpunimit të brendshëm të kontejnerëve, taksat doganore dhe aeroportuale”, pohoi z. Arben Shkodra.

Për presidentin e Shoqatës së Eksporteve Shqiptare, Alban Zusi, masat në mbështetje të prodhimit, duhet të jenë sektoriale dhe të konsultuara me grupet e interesit. “Duhet krijuar grupe sektoriale të përhershme dhe të konsultohet me to marrja e masave.

Ndër të tjera duhet të zhvillohet edhe analiza makro brenda secilit zinxhir prodhimi, për të kuptuar se cili është problemi më i madh i krijuar. Për shembull, në sektorin e prodhimit të qumështit dhe mishit, problem është lënda e parë për kafshët. Atëherë, zgjidhja duhet të mendohet se si duhet të ulim koston e lëndës së parë për kafshët. Do të sjellim misrin nga Serbia me 50 – 60 euro transportin tokësor apo do ta sjellim me anije të mëdha.

Zgjidhje tjetër është edhe ngritja e dhomave të tharjes në zonat ku prodhohet misri, pasi është paraqitur si shqetësim mospasja e tyre që fermeri nuk prodhon. Për këto arsye, misri importohet nga jashtë. Por kjo rrit koston e përpunimit të qumështit, mishit dhe produkteve blegtorale. Në rastin e prodhimit të verës vendase, është e domosdoshme të kontrollohet çmimi i importit”. Drejtuesi i Shoqatës së Eksporteve shton gjithashtu se për disa masa mbështetëse ndaj prodhimit vendas, duhet të orientohejmë nga tregu global ku aktualisht po ndodhin shumë lëvizje.

“Në rastin e prodhimit të vajit të lulediellit po krijohen monopole të fuqishme

ndërkombëtare, të cilat po bllokojnë lëndën e parë, me qëllim rritjen e çmimit të vajit të lulediellit. Janë disa masa që nuk kanë të bëjnë vetëm me tregun shqiptar dhe politikëbërjen shqiptare. Por si do të reagojmë ndaj këtyre trendeve ndërkombëtare që siç duket do të zgjasin?

Kjo është një turbulencë botërore dhe në këtë periudhë është e domosdoshme të krijojmë ekupe pune sektoriale, për marrjen e masave dhe zgjidhjen e secilit problem sektorial. Nëse grupet e mëdha të interesit në botë po mblidhen dhe po bëjnë marrëveshje, atëherë edhe ne duhet të bëjmë marrëveshje të mëdha brenda vendit për të amortizuar këtë situatë”.

Si do të ndihmohet prodhimi vendas nga shteti

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, znj. Milva Ikonimi, tha se deri tani janë ndërmarrë një sërë nismash në drejtim të mbështetjes dhe rritjes së konkurrueshmërisë së prodhimit vendas.

Ministria e Bujqësisë renditi, si masa mbështetëse: subvencionimin nga buxheti i shtetit; lehtësitë fiskale: heqjen e TVSH-së për makinat bujqësore, si në import ashtu dhe brenda vendit; heqjen e TVSH-së për inputet bujqësore; akcizën e naftës për anijet e peshkimit; skemën e subvencionimit të naftës për fermerët; grantet nëpërmjet projekteve të huaja: IPARD, BERZH, Protokolli Italian, Qeveria Gjermane, etj; gjenerimi i të ardhurave nëpërmjet rritjes së konkurrueshmërisë së produkteve me skemat të cilësisë, si dhe nisjen e punës për hartimin e strategjisë së re ndërsektoriale për bujqësinë, zhvillimin rural dhe peshkimin 2021-2027, në të cilën do të përcaktohen hapat konkretë që do të merren për të ardhmen e sektorit.

Nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në mbështetje të prodhimit vendas zbatohen Marrëveshjet e Tregtisë së Lirë, si: CEFTA, EFTA, me Turqinë, MSA dhe Mbretërinë e Bashkuar dhe Irlandën e Veriut. Shqipëria është edhe anëtare e OBT-së.

“Në këto marrëveshje janë të përcaktuara tarifat preferenciale, kuotat, tarifrat, lidhur me shkëmbimet tregtare për produktet bujqësore dhe ushqimore. Mbrojtja e prodhimit vendas është siguruar nëpërmjet vendosjes së kuotave për produkte të caktuara, ose çmimeve preferenciale”.

Ministria Ikonimi theksoi se situata e krijuar nga pandemia nuk e preku shumë sektorin e bujqësisë. “Puna në këtë sektor vazhdoi dhe për vitin 2020, patëm rritje të prodhimit kryesisht te: pemët frutore, ulliri, perimet, misri, bimët aromatike mjekësore, prodhimi i rrushit, etj.”



TASE GROUP

Adresa: Rruga e Kavajës, Qendra Kondor (ish parku i autobuzave, poshtë "21 Dhjetorit"), Tiranë
Tel: 0035542239968; Fax/Tel: 0035542220027; e-mail: info@tasegroup.al;
Website: www.tasegroup.al; Celular: 0684855580 (Kushineta, Premistopa dhe rripa)
Celular: 0672035581 (Pjesë këmbimi për traktorë)



Ofrojmë:

- PJESE MOTORIKE
- FREKSIONE
- PERMISTOPA
- KUSHINETA
- RRIPIA
- AKSE
- PJESE ELEKTRIKE
- PJESE HIDRAULIKE
- VAJRA DHE FILTRA



KASH

Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar

www.kashalbania.org

Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar



Deri në **4 500 000 LEKË**

KREDI PËR SERA PA KOLATERAL



GJITHMONË FINANCË SOCIALE

Rr. Qemal Stafa, Pall. 9 katësh, Nr. 70, Kati 2, Pazari i Ri, Tiranë.
+355 4 2251910/1 | info@fedinvest.al | www.fedinvest.al

Kolegu ynë, gazetari Shefqet Meko na befaso! me romanin e tij “Saga përtej Atlantikut”. Nuk është rastësi arritja e tij deri këtu. Ai ngjiti disa shkallë për të mbërritur deri te romani. Qysh student boton në faqet e shtypit të kohës. Pas mbarimit të fakultetit, për 10 vjet ishte kryeredaktor i gazetës “Studenti i bujqësisë”, e cila u bë zëri i studentëve të Institutit të Lartë Bujqësor, sot Universiteti Bujqësor i Tiranës. Pas viteve ’90, filon punë në Radio “Tirana” ku la gjurmë të pashlyera. Me nismën e tij në vitin 1994, u krijua Shoqata e Gazetarëve Shqiptarë të Bujqësisë, ku Shefqeti ishte kryetar i parë i saj. Ai e antarësoi shoqatën në IFAJ (Federata Botërore e Gazetarëve të Bujqësisë). Prej 22 vjetësh jeton në Amerikë, ku është integruar plotësisht në jetën amerikane. Pasioni i krijimtarisë e ka ndjekur edhe në emigrim, ku ka shkruar artikuj problemorë si dhe tre libra: “Unë ikanaku shqiptar”, “I tillë jam” dhe së fundi romanin “Saga përtej Atlantikut”. Me pasionin që ka, Shefqeti do na gostitë përsëri me krijime të tjera të bukura.

Shefqet Meko gazetari i njohur i ish-Radio Tiranës, publicist dhe një emër i njohur në median Bujqësore, promovoi në mesmuajin shtator në Tiranë, romanin e tij “Saga përtej Atlantikut”.

Në ceremoninë e organizuar për promovimin e librit të tij, merrnin pjesë personalitetet të botës akademike, diplomatët Arben Çejku, Albert Rakipi, shkrimtarët e njohur Besnik Mustafai, Prof. Hulusi Hako, Ahmet Prençi, gazetarë, dashamirës të librit dhe miq të Shefqetit, që kishin ardhur nga Amerika në Tiranë dhe mbledhi bashkë artdashës dhe miq të tij.

Meko në fjalën e tij, mes emocionesh u shpreh: “Jo vetëm se jemi mbledhur sot këtu, por për ne të ikurit, Shqipëria ka mbetur po ajo në shpirt”. Ai falenderoi pjesëmarrësit për dëshirën që shprehin të lexojnë librin e tij. Ndërsa, një falenderim të veçantë adresoi për Bujar dhe Miranda Karoshin dhe shtëpinë botuese M&B, redaktorin Dëfrim Cani, korektoren Alma Meko (Balli), Mjeshttrin Zaim Elezi (Zaja), Elzana Agollin për kopertinën dhe Arben Çejkun me kompozimin e “Metamorfozës” që përmbledh në një diciturë atë tronditje emocionale që shkakton i gjithë romani

“Falenderoj Ahmet Prençin, që më ka nxjerrë nga pluhuri i harresës dhe më tha “zgjohu”. Ashtu sikurse dua të falenderoj mikun tim të vjetër Hashim Jaccellari, që do t’i lexonte dëshirat e mia të para, duke më thënë: “vazhdo se mund të shkruash dhe të kesh sukses”, tha Meko.

“Të jem i sinqertë, vijoi ai, unë nuk i përkas atyre njerëzve që kanë ëndërruar Amerikën, duke qenë në Shqipëri. Unë i përkas asaj pjese, ku dhuna dhe sistemi thonin: “Dëgjo çfarë them unë”. Megjithatë falë atij vrulli që ndodhin në fund vitit ’90, u ndryshuam të gjithë. Unë e kam dashur Shqipërinë aq sa e doni dhe ju. Unë kam qenë dy herë në USA dhe jam kthyer me dëshirë, se do të bëhet Shqipëria dhe unë prap besoj se Shqipëria do të bëhet sepse ka njerëz të mirë”.

Meko tregoi se kur vajti në USA bëri një dosje të madhe, me dëshirën që mund të fillonte

“Saga përtej Atlantikut”- Promovohet libri i Shefqet Mekos, reflektim mbi çështjet që përballet shoqëria shqiptare

te “Zëri Amerikës” dhe të bënte gjëra të mëdha. “Por Amerika - tha ai - ka një trill shumë interesat që është “Harro çfarë ke qenë në vendin tënd, shiko ç’mund të bëhesh këtu”.

“Ai vend të hap dyert dhe ai vend bëhet si të thuash shërbëtori yt në kuptimin e shërbimeve të gjithanëshme dhe ne që shkojmë në USA, gjejmë shumë gjëra të mira, që Shqipëria sot e 30 vjet nuk i ka ngritur ende atje ku duhet. Pikërisht ato gjëra që

në, por vetë prania juaj këtu më kujton atë dëshirë njerëzore që njeriu mbetet gjithmonë i mirë edhe pse e keqja mundohet të lëvizë si ai bari i keq gjithandej dhe Shqipëria dhe ju, keni të mirën brenda dhe e mira do të fitojë”.

Botimi i romanit të Shefqet Mekos “Saga përtej Atlantikut”, ishte një ngjarje e rëndësishme për autorin dhe lexuesit.

Në optikën e poetit dhe shkrimtarit Ahmet Prençi, ro-

familjes, shoqërisë, të njeriut me shtetin etj. Kryepersonazhi i romanit Xhelo Lakrori ngjan me një pluskim të qartë në realitetet përkatëse, duke i dhënë romanit një komunikim të jashtëzakonshëm.

Romani është shkruar me një stil rrëfyes dhe emocionalitet që të mban mbërthyer deti në faqen e fundit”.

Ndërsa Arben Çejku, në recensën e përgatitur mbi këtë libër tha: “Pak kohë më parë lexova dorëshkrimin e romanit, “Saga përtej Atlantikut” të shkrimtarit Shefqet Meko. Libri tani sapo ka dalë në qarkullim dhe për koincidencë, bashkë me të, rrugëve të atdheut po qarkullon edhe vetë autori, i sapoardhur nga SHBA pas 10 vitesh mungesë. Duket sikur Xhelo Lakrori, personazhi kryesor i romanit e “bindi” Shefqetin që të vijë në Tiranë. Apo Shefqeti e solli

lojnë gjeografinë shpirtërore të autorit të tyre, duke u shndërruar në vlera të artit tonë kombëtar.

Të dyja këto vepra, janë përgatitur dhe botuar nën përkujdesjen e jashtëzakonshme të një miku e shkrimtari të talentuar, zotit Ahmet Prençi. Përmbledhja me tregime “I tillë jam”, më erdhi në dorë pak para se ajo të mbrinte në SHBA tek autori. Shumica e tregimeve ishin ribotim i publikimeve të bëra në vitet ’80, të shekullit të kaluar dhe përveç vlerës artistike, ato më sillnin para syve histori, ngjarje, personazhe, përjetime, meditime dhe realitete të një kohe të kaluar, pjesë e së cilës, në një mënyrë ose tjetër kam qenë edhe unë.

Shefqetin e kam njohur si koleg gazetar pas viteve ’90 dhe më bëri përshtypje stili lakonik dhe gdhendja mjeshtrorë e per-



man “Saga përtej Atlantikut”, që Shefqet Meko po i jep lexuesit shqiptar, është një risi mjaft interesante që trajton fenomenet e mprehta sociale, profilet e veçanta të personazheve dhe frymën social – kohore që ata mbartin në vetvete.

Ky libër, trajton thellësisht një raport të brendshëm të kohës dhe vendeve. Skanon situata që lidhen me historinë, psikologjinë dhe individin në një shoqëri të kufizuar politikisht, kulturalisht dhe psikologjikisht siç ishte komunizmi. Nga ana tjetër na paraqet në mënyrë të detajuar mjedisin e një shoqërie të vendit të lirë, në Amerikën e përtej Atlantikut ku autori jeton prej vitesh. Diversiteti i dy kohëve dhe metamorfoza që ndodh me personazhin që i jeton dy kohët dhe dy vendet është në thellësi të këtij romani mjaft të spikatur e të veçantë.

Kontrastet e thella shtrihen në të gjithë subjektin dhe personazhet, të cilët valorizojnë të dhëna, dëshmi dhe informim të nevojshëm kohor, njerëzor dhe shoqëror. Kjo e bën romanin tejet interesant në të gjitha faqet e tij.

Romani përcjell mjaft mirë një dëshmi social-psikologjike të fatit të individit dhe pesha që ai mbart në dy shoqëritë, atë totalitare dhe atë të lirë. Në një subjekt të zhdërvjellët, Shefqet Meko arrin të na e tipizojë një personazh të tillë, i cili nënkupton fatë popujsh.

Romani mbart dy realitete njerëzore me gjithë marrëdhëniet, që nga ato të dashurisë,

Xhelon si “pararojën” e vizitës së tij? Nuk ka më bukur se kur autori dhe personazhi kryesor i romanit “shoqërojnë” njëritjetrit kudo ku hyjnë e dalin. Miqtë dhe shokët e dikurshëm i gëzohen një takimi apo kafeje me Shefqetin, po aq sa bëhen kureshtarë të njohin sa më parë edhe “krijesën” e tij më të re, Xhelo Lakrorin dhe sagën e tij shqiptaro – amerikane. Në fund të fundit, Shefqeti do të rikthehet në Amerikë, kurse Xhelo Lakrori do të mbetet këtu mes nesh si një mesazh dhe amanet nga shkrimtari. (Autorët shkojnë e vijnë – veprat mbesin!). Shefqeti, si shumë emigrantë të tjerë, mes përditshmëisë së tyre në vendet

sonazheve në tregimet e tij të shkurtra. Pasi kam mbaruar së lexuari tregimet e tij, mësova se ai nuk kishte provuar prozën e gjatë, me përjashtim të ndonjë sprove të lënë përgjysmë. Tashmë Shefqeti kishte rënë në “gjumë letrar” dhe prej më shumë se 20 vitesh ai nuk kishte shkruar dhe botuar asgjë. Përmbledhja me tregime e botuar me nxitjen dhe përkujdesjen e zotit Prençi, më shumë dukej si epilogu i një karriere letrare të lënë në mes, sesa prologu i një filimi të ri letrar. Por ata që janë shkrimtarë, ata që e kanë talentin brenda vetes, kurrë nuk e dinë se kur do të “vdesin” artistikisht! Shefqet Meko, me romanin e tij

Ashtu si 20 vite më parë, kur i “hyri në këmbë” detit të emigracionit dhe i arriti qëllimet e tij personale e familjare, edhe tani, kur i “hyri në këmbë” detit të prozës së gjatë, Shefqeti ia doli me sukses të shkruajë një roman me vlera. Kjo, pikë së pari tregon fuqinë e një karakteri fisnik dhe mençurinë e një intelektual mendjehapur, i cili përvojat e tij jetësore, i kthen në dritë shpresë për të tjerët që vijnë pas tij. I bindur se “Saga përtej Atlantikut”, është një histori ku mund të gjejmë veten mijëra emigrantë shqiptaro-amerikanë, Shefqeti kujdeset që nëpërmjet krijimit të tij letrar, të konvergojë fatet e shumë e shumë njerëzve, por mbi të gjitha të nxjerrë në pah mesazhet e dhura për sot e për nesër. Ndaj mund të them se, “Saga...” është një vepër letrare gjithëpërfshirëse, të cilën do të kishte dëshirë ta shkruante çdo emigrant, që lufton përditë për ardhmërinë e tij, duke mbajtur këmbët gjithnjë në tabanin e historisë dhe vlerave të kombit nga vjen.

Në qendër të romanit pra, është Xhelo Lakrori, shqiptaro – amerikan, që punon për të ardhmen e tij amerikane, pa u shkëputur plotësisht nga reminishencat, formimi dhe sjellja e tij si “njeri i ri” i së kaluarës socialiste. Edhe pse nuk është çliruar plotësisht nga e kaluara e tij, ajo gjithësesi, nuk e pengon dot atë që të ecë përpara. Xhelo i realizon objektivat e veta, sepse e ndihmon sistemi në vendin ku jeton. Hija e së kaluarës thjesht i tërheq vëmendjen, mendimet, i merr kohë në ripërtypje ngjarjesh e fenomenesh, e cyt që të paralelizojë momente të së përditshmës, por nuk ka fuqinë e stërkëmbshit për ta penguar. Xhelo ka forcë për të tejkaluar jo vetëm të kaluarën, por edhe vetveten. Ai ka kuptuar vlerat e vetes falë lirisë që gëzon në vendin ku jeton. Ai në këtë vepër himnizon lirinë individuale. Sipas autorit, kjo është baza fundamentale e dinjitetit njerëzor. Pa lirinë individuale të garantuar dhe funksionale, çdo gjë tjetër është fallsitet dhe tallje. Por Xhelo na thotë se këto vlera mund të rrezikohen nga individë dhe grupe individësh, të cilët vënë në qendër të veprimtarisë së tyre interesat personale, duke dëmtuar karakterin dhe moralin.



ku jetojnë dhe atdheut që u mungon, me sytë e mendjes dhe të zemrës, çdo ditë ndërtojnë nga një urë që i mban gjallë. Secili në mënyrën e tij! Ata që bëjnë libra, siç bën Meko, e bëjnë urën më të fortë, më të dukshme dhe më të përjetshme. Romani “Saga përtej Atlantikut” si dhe përmbledhja me tregime “I tillë jam”, janë dy vepra shumë të rëndësishme letrare, të cilat e tejka-

të ri, tregoi se talenti nuk vdes kurrë, se ai ringrihet si Sfinks! Nxitja miqësore dhe inkurajimi që ka patur nga Ahmeti janë njëra anë e medaljes, ndërsa vullkani i një talenti të mbushur plot me dije dhe eksperiencë të jashtëzakonshme personale, janë ana tjetër e saj. Të dyja së bashku “ringjallën” Shefqetin si shkrimtar, siç thotë edhe ai vetë këto ditë.

I tillë është, p.sh, një nga personazhet e rëndësishme të romanit, Miç Miller, një milioner që ia ka me hile jo vetëm Xhelos por edhe shtetit të tij. Në sytë e Xhelo Lakrorit, ai ngjan gjithnjë e më shumë me një nga ato drejtuesit e firmave piramidale në Shqipërinë e vitit 1997, që u

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT TË BUJQËSISË, SIGURISË USHQIMORE DHE ZHVILLIMIT RURAL

QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE FUSHË KRUJË

(Vijon nga gazeta paraardhëse)

• Objektivi i parë në të ushqyerit e lopëve në fillim të laktacionit është për të rritur sasinë e ushqimit sa më shpejt të jetë e mundur me qellim që lopa të mund të minimizojë mungesat në lëndë ushqyese. Sidoqoftë duhet të tregohet kujdes që ne arrijen e këtij objektivi të mos kemi një ndryshim drastik por gradual pasi kjo do të shkaktohte probleme në tretje. Realizimi i këtij objekti (futja në diete të plotë e përputhur me nevojat në lëndë ushqyese të lopës duhet të arrijë në ditën e 20 –të pas pjelljes). Suksesi i arritur në këtë periudhë në drejtim të ushqyerit do të rrisi në maksimum prodhimin pik, do të minimizojë humbjen në kondicion trupor, do të ulë në minimum rastet e çrregullimeve metabolike dhe do te vendose nje balance energjitike pozitive tek lopa në javën 10-12-të pas pjelljes.

• Në fillim të laktacionit, lopët janë të afta për të siguruar energji e nevojitur nga mobilizimi i rezervave energjitike të organizmit, por për proteinen kjo nuk është aq e lehtë. Dietat për këto lopë janë mjaft të larta në energji dhe proteinë se sa racionet ushqimore për grupet e tjera, meqenëse sasia e ushqimit është e kufizuar për shkak të aftësisë ngrënëse të kufizuar. Densiteti energjitik i racionit ushqimor mund të rritet nëpërmjet suplementimit me yndyrë të tij ose rritjes se përmbajtjes në drithëra të racionit ushqimor. Të dy mënyrat kanë anë të pozitive dhe negative. Nga njëra anë, shtimi i yndyrës në racion do të rrisë densitetin energjitik duke mos shkaktuar acidoze dhe rënie të yndyrës se qumështit, në anën tjetër, jo të gjithë burimet yndyrore janë të shijshme dhe duke shtuar shumë yndyrë në dietë, kjo mund të ndikojë negativisht në zhvillimin jo normal të procesit të fermentimit në plëndës dhe tretjen e fibrës.

• Rritja e përmbajtjes se racionit ushqimor në drithra (koncentrat) është një mënyrë tjetër për të rritur densitetin energjitik të racionit. Përdorimi i dietave me përmbajtje të lartë në drithëra siguron me shumë energji për sintezën e qumështit dhe mund të rrisë gjithashtu dhe sintezën e proteinës se qumështit. Dritherat, shpesh kanë një çmim më të ulët se sa yndyra kur përdoret si suplement. Përpilimi i racionit ushqimor është një veprim ballancues. Megjithatë, rritja në përmbajtje me drithëra (koncentrat) e racionit ushqimor rrit sasinë e energjisë në racion, kjo mund të rrisë rrezikun e acidozës dhe të abomazusit të ç'vëndosur.

• Në një racion ushqimor, raporti koncentrat : forazhe (rac. baze) mund të rritet deri në një maksimum 60:40 (60 % ushqim i koncentruar dhe 40 % forazhe). Një racion total i përzier është një dietë ku të gjithë perberesit ushqimorë përzien se bashku përpara se t'ju jepet kafshëve. Të ushqyerit “unifid” i siguron lopes një ushqim të plotë në perberes duke bërë që lopa të mos hajë vetëm atë ushqim që pelqen (në mënyrë selektive). Në qoftëse nuk zbatohet të

ushqyerit “unifid”, sasia e koncentrates duhet të rritet ngadalë dhe kjo sasi duhet t'ju jepet lopeve 3 herë në ditë.

• Për shkak se të ushqyerit e lopëve në fillim të laktacionit është një veprim ballancues i tillë dhe është shumë e rëndësishme për prodhimin e qumështit, shpesh për këto grup përdoren aditive në diete. Suplementimi i dietës me bufer të tillë si bikarbonati i natriumit ose oksid magnezi mund të jetë e dobishme për lopët që ushqehen me racione ushqimore me përmbajtje të lartë në koncentrat ose dieta me sasi të madhe silazh misri. Glukol propileni mund të përdoret ngjandjeherë në keto lope me qellim për të parandaluar ketozen.

• Gjithashtu përfshirja në racionin ushqimor të sasi të vogël bari të thatë të coptuar ose të pa coptuar rrit shijen dhe ruan funksionimin normal të plëndës. Kërkimet kanë treguar se përfshirja e barit të thatë të pa coptuar (me gjatësi natyrale) në dietë ose rritja e madhësisë së pjesëzave të forazheve do të ulë rastet e abomasusit të ç'vëndosur.

Grupi i dytë: Lopët në mes të laktacionit

Në këtë grup përfshihen lopët që ndodhen nga java e 12-të – 24-të pas pjelljes.

• Ky është stadi i laktacionit ku lëndët ushqyese të konsumuar nga lopa plotësojnë mjaft mirë nevojat për nivelin e prodhimit të saj. Objektivi i të ushqyerit në këtë grup është për të arritur sasinë maksimale të konsumit të lëndës thatë dhe një balance energjitike pozitive sa më shpejt të jetë e mundur për të ruajtur prodhimin e lartë të qumështit. Gjithashtu, në fillim të kësaj periudhe pjesa më e madhe e lopes mbarsen sepse balanca energjitike pozitive përmireson shkallën e fekunditetit.

• Në këtë stad laktacioni sasia e lëndës se thatë të konsumuar duhet të arrijë 3-4% të peshës gjalle për pjesën më të madhe të lopes. Kjo ndryshon në vartësi të lopes dhe nivelit të prodhimit. Sasia e ushqimit të konsumuar është zakonisht më e madhe në lopët me prodhimtarinë më të lartë. Disa lope kanë aftësi të konsumojnë deri në 5% të peshës gjalle. Densiteti energjitik dhe % e proteinës në dietë mund të jete pakez me i ulët gjatë këtij stadi laktacioni se në fillim të laktacionit sepse sasia e ushqimit është më e madhe.

• Megjithatë lopët kanë më pak probleme digjестive gjatë periudhës së mesme të laktacionit krahasuar me lopët në fillim të laktacionit, akoma duhet të tregohet kujdes për të siguruar sasinë e mjaftueshme të fibrës dhe madhësinë e pjesëzave. Raporti kosto fitim duhet të analizohet me kujdes kur dieta suplementohet me aditive ushqimore për këtë grup lopësh, meqenëse në këtë stad laktacioni lopët nuk janë të prirur të kenë çrregullime metabolike si në stadin e parë të laktacionit.

Grupi i tretë: Lopët në fund të laktacionit

Lopët lëvizin në grupin e tretë kur ato janë barse dhe prodhimi i qumështit ulët dhe ndërkohe rritet peshja e gjallë e lopëve.

• Kjo është periudha më e mirë për vendosjen e rezervave trupore për laktacionin e ardhshëm. Periudha e kohës që një lope qëndron në secilin stad do të ndryshojë në vartësi të vete lopes dhe kushteve të disponueshme.

• Nga të gjitha grupet, grupi i lopëve në periudhën e fundit të laktacionit mund të jetë grupi më i lehtë për tu menaxhuar, sepse sasia e lëndëve ushqyese të marra nga dieta është

zakonisht më e madhe se nevojat, prodhimi i qumështit ulët dhe lopa duhet të jetë barse. Ky grup është koha në të cilin lopa duhet të rivendoset peshën e gjallë që ajo humbi gjatë prodhimit të lartë të qumështit në fillim të laktacionit.

• Qëllimi kryesor në këtë stad është që lopa të arrijë kondicionin trupor të duhur përpara tharjes dhe të ruaj prodhimin e qumështit në një nivel sa më të lartë të jetë e mundur dhe me shpenzime efektive.

• Në këtë stad laktacioni, sasia e koncentratës së përdorur është më e vogël se në stadet e tjera dhe gjithashtu përdorimi i aditivëve ushqimorë është në sasi shumë të vogla duke bërë që kosto e ushqime të përdorura të jetë më e ulët.

Tabela 1. Nevojat ushqimore të lopëve Holshtein sipas stadi të laktacionit

Emërtimi	Stadi i laktacionit		
	Fillim	Mes	Fund
Prodhi. Mesat. Qumështit (kg/ditë)	40	30	20
Lëndë e thatë (kg/ditë)	24-26	21-23	11 - 12
Proteinë bruto (% ndaj l. thatë)	17-19	15-16	13-15
PPP (% ndaj prot.bruto)	35-40	30-35	25
Prot. tretshme (% ndaj prot.bruto)	25-33	25-36	25-40
NDF (% ndaj l. thatë)	30-34	30-38	33-42
ADF (% ndaj l. thatë)	19-21	19-23	22-26
Fiber efektive (% ndaj NDF)	25	25	25
E NL (Mkal/kg)	1.64	1.57	1.5
NFC (% ndaj l. Thatë)	30-42	30-44	30-45
TDN (% ndaj l. Thatë)	72-74	69-71	66-68
Yndyrë(max. ndaj l. thatë)	5 - 6	4 - 6	3 - 5
Kalcium-Ca (% ndaj l. thatë)	0.8-1.1	0.8-1.0	0.7-0.9
Fosfor- P (% ndaj l. thatë)	0.5-0.9	0.4-0.8	0.4-0.7
Kalium-K(% ndaj l. thatë)	0.9-1.4	0.9-1.3	0.9-1.3
Natrium-Na (% ndaj l. thatë)	0.2-0.45	0.2-0.45	0.18-0.45
Klor-Cl (% ndaj l. thatë)	0.25-0.30	0.25-0.30	0.25-0.30
Squlur-S (% ndaj l. thatë)	0.22-0.24	0.20-0.24	0.20-0.22
Kobalt-Co (mg/kg l. thatë)	0.2-0.30	0.2-0.30	0.2-0.30
Baker-Cu (mg/kg l. thatë)	15-30	15-30	12 - 30
Magnez-Mg (mg/kg l. thatë)	60	60	50
Zink-Zn (mg/kg l. thatë)	80	80	70
Jod -J (mg/kg l. thatë)	0.8-1.4	0.6-1.4	0.6-1.2
Hekur-Fe (mg/kg l. thatë)	100	75-100	50-100
Selen Se (mg/kg l. thatë)	0.3	0.3	0.3
Vitaminë A (1000UI/ditë)	100-200	100-200	100-200
* D (1000UI/ditë)	20-30	20-30	20-30
* E (UI/ditë)	600-800	400-600	400-600

Duhet të kemi parasysh:

• Gjedhi ka një potencial gjenetik për

Drejtoria e Teknologjive Blegtorale, QTTB-Fushë Krujë:
E-mail:qttbfushekrue@yahoo.com

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT TË BUJQËSISË, SIGURISË USHQIMORE DHE ZHVILLIMIT RURAL

QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE FUSHË KRUJË

(Vijon nga faqja 11)

prodhimtari të ndryshme, dhe një ndër faktorët thelbësor që influencon në të është të ushqyerit.

- Marja e ushqimit ndikon direkt në kondicionin e kafshës dhe prodhimtarinë e saj.
- Në lopët me prodhimtari të lartë plotësimi i nevojave është jo i lehtë për shkak se kapaciteti i tyre ngrënës veçanërisht për ushqimet vëllimore është i kufizuar. Ushqimet vëllimore dhe të koncentruara (3:1 deri 1:1) .
- Përzjerja e komponentëve të ndryshëm të racionit ushqimor rinisin ngrënshmërinë dhe tretshmërinë e ushqimeve.
- Të ketë vlerë të plotë në të gjitha substancat në perputhje me nevojat
- Të jetë i balancuar duke ruajtur raportet ndërmjet proteinave dhe substanca jo proteinike.
- R. E/P (1 NjQ- 100 gr proteine) - prodhimtari e lartë
- Të ngopë gjedhin në vartësi të volumit të aparatit tretës 3.5-4.5 kg L.TH për çdo Kv peshe të gjallë
- Të sigurojë një strukturë normale në përbërësit e tij.
- Të konsumohet me dëshirë nga kafshët

- Të prodhohet ose blihet me leverdi ekonomike
- Sigurimi i foragjereve voluminoze (te njoma dhe te thata).
- Lopa me prodhimtari te lartë qumështi, me peshë 500 -600 kg duhet të konsumojë 60 kg njomishte ose 10-15 kg bar të thatë në ditë.

- Sigurimi i ushqimeve te koncentruara.
- Ushqimet e koncentruara jepen sipas sasisë së prodhimit ditor të qumeshtit, duke u shtuar sipas rritjes se prodhimit të qumështit në sasi 250-300 gr/per/litrë qumësht.

- Sigurimi i lëndëve minerale (50-80 gr kripe gjelle)
- Cikli prodhues i lopës ndahet në katër faza:

- Faza e nisjes- 2 muajt e parë të laktacionit
- Faza e prodhimit- në mes të laktacionit
- Faza e rikuperimit- komp. humbje peshe
- Faza e përgatitjes- fundi i periudhës së tharjes, rritet gradualisht koncentrata
- Ky nivel varet nga këto faktorë:
- Natyra e ushqimit
- Ngrënshmëria
- Cilësia
- Përmbajtja e lëndës së thatë
- Përbërja e racionit
- Mënyra e dhënies- 2 x 4 orë ose ad libitum
- Pesha e kafshës
- Stadi i laktacionit- rritet pas muajit të tretë
- Prodhimi ~ Konsumi

TE USHQYERIT E VIÇAVE NE KUSHTET MBARESHTIMIT ½ EKSTENSIV

- 1. Kujdesi per viçin deri në procesin e

TË USHQYERIT E KAFSHËVE TË FERMËS

- lindjes si dhe orët e para së paslindjes.
- Proçesi i tharjes se viçit si dhe rëndësia e kulloshtrës
- Dhënia e kulloshtrës – 10% te peshës së trupit të lopës duke që në sekrecionin e parë pas pjelljes nga gjiri i lopës ajo ka këto cilësi;
- Plotëson nevojat ushqimore
- Është e pasur në sasinë tre herë më shumë në lëndë të thatë (L.Th.) se qumështi.
- Përmban 4-6 herë më shumë proteina se në qumësht.
- Është e pasur me imunoglobulina dhe siguron antitruapat për mbrojtjen e vicit [në të gjenden 50 herë më shumë IMUNOGLOBULINA]
- E pasur me lëndë minerale dhe vitamina.
- Ndihton në aktivizimin e peristaltikës së zorrëve dhe daljen jashtë të mekoniumit.
- .Garantohet në sasi cilësi, dendësi etj.si dhe ofrohet ujë..

- 2. Vici duhet te ndahet nga nena mbas 12 orësh sipas rrreg.se BE

Viçi mundet të rrijë me lopën dhe merr qumësht sipas dëshires deri në 15 ditë,ose ushqehet me biberon me 6 kg qumësht,[temperaturë, sasia, cilësia,..]

Viçi kalon në bokse individuale por nuk duhet të izolohen, duhet të kenë mundësi të shohin, të prekin njeri-tjetrin si edhe lopët.

Rëndësi ka të njihen mirë dhe të bëhen analiza përkatëse për parametrat e qumështit pluhur në rastin e zëvendësuesve të qumështit , dhe të rritet sasia e LTh ne menyre qe te plotesoje nevojat

- 3. Vazhdon dhënia e Qumeshtit ne sasine 6 kg ,ne dy vakte per periudhen tjeter.derikur fillon procesi i keputjes, dhe racionin e Qumeshtit ulet sasia në 10%. Zvogëlimi i sasisë së qumështit bëhet gradual deri sa:

- Racioni ushqimor i tij duhet:
- Të sigurojë plotësimin e nevojave të tij në energji dhe proteina.
- Të sigurojë pavarësinë e vicit nga nëna.

Në fazat e para të rritjes ekziston një korelacion pozitiv midis kohës se dyfishimit të peshës në lindje dhe përmbajtjes se qumështit të nënës në substance ushqimore dhe veçanërisht në protein.

Viçi stimulohet me ushqim suplementar, me koncentrat si dhe me bar të thatë të cilësisë së mirë

Rritja është funksion i komplikuar biologjik rezultat i shumëzimit dhe diferencimit të qelizave.Ndryshimet në kafshët në rritje sjellin pjekurine dhe rritjen e peshës trupore.

Nga pikpamja biokimike rritja perfaqeson elementet perberes te shteses se peshes ; ujin ,proteinen , lendet minerale,yndyrnat qe ndryshojne ne raport me moshen, peshen, dhe te ushqyerit.

Shtesa e peshes per njesi te kohes [dinamika e rritjes] eshte me e larte , sa me e vogel te jete moshja dhe ulet me avancimin e saj.In-

tensiteti i rritjes eshte me i larte ne moshe te vogel. Dhe kemi shperblim te ushqimit me te mire per njesi prodhimi.

Suksesi i rritjes se vicave 0-3 muaj varet nga kujdesi per lopet ne tharje sepse:

- Rivendoset rezerva trupore
- Ripërterihet gjiri dhe
- Zhvillim normal i vicit.

Tregues kryesor per shtesen e peshes eshte vlera kalorike per te percaktuar vlerat energjike reale per rritje.,

Kur shtesa permban 25% protein dhe 32 % yndyre vlera kalorike eshte ;

250 gr protein (25% x 5.7 k/kal/gr=1424 k/kalori

320gr yndyre (32%) x 9.5 k/kalori/g=3040 k/kalori

Vlera kalorike rritet me avancimin e moshes e peshes se kafsheve.

8. Rritja në fazat e para bëhet si rezultat i zhvillimit të indit muscular dhe rol vendimtar luajnë proteinat e marra me ushqim.

9. Gjate 2-3 javet e para nuk duhet te kerkohe rritje e shpejte qe kerkon konsumimin e sasive te mëdha e lidhur kjo me aftesine trette dhe nivelin metabolic te vicit.sduhet tejmbushje e plendesit pasi japin diare.

10. Te rritet % e LTH në zvendësues të qumeshtit në menyre progressive duke pasur parasysh nevojat e vicave. .

11. Ne kohen e ndryshimit te ushqimit duhet te perdoret nje ushqim kalimtar per 4-5 dite deri ne pershtatjen e vicit

12.Vici fillon te marre ushqim duke filluar nga java e dyte forazhe dhe concentrate

13 .Periudha e zverdhjes qe perfshin dy javet e fundit te periudhes se qumeshtit gradualisht zvogelohet sasia e qumeshtit me 10% deri ne nderprerje, rritet konsumimi i ushqimeve te koncentruara [sa me i vogel sasia e qumeshtit aq me i madheë sasia e concentrates]

14. Periudha me pasme vici ka arritur nje aftesi relativisht te qendrueshme te ngrënies se ushqimeve. Dhe nuk behet shkeputja pa arritur vici te marre sasine prej 900 gr ushqim te koncentruar.

15.Ne moshen 3 muajshe vici peshon 150 kg dhe merr 1.5kg concentrate dhe duhet te marrin 1.5 kg/LTH ne dite por nuk duhet te kufizohet kjo sasi,

16.nxirret nga boksi individual .

17.Ne kushtet e mbareshtimit gjysem ekstensiv vici dalin ne kullote dhe marrin atje nje pjese te mire ose dhe te gjithë sasine e forazheve, kujdes duhet te tregohet per numrin e krereve , per siperfaqen e kullotes, llojin e bimesise qe ka kullota, te behen analizat perkatese dhe te behet krahasimi me nevojat te merren masa per plotesimin e nevojave te tyre.

Duhet te kemi parasysh se;

Vici ne muajt e pare te jetes duhet tu jepen ne menyre te kushtezuar ushqime te njoma

pasi japin diare dhe vicit i duhet kohe qe testabilizojë aparatn tretes,

- Rendesi kur viçat nxirren në kullotë ka :
- Bimesia
- Shkalla e zhvillimit të bimësisë
- Sasia e lëndës së thatë që sigurohet etj

Menaxhimi i energjisë
- Strategjitë e thjeshta të menaxhimit janë të mjaftueshme për të përmirësuar ndjeshëm marrjen e MS dhe prodhimin e qumështit.

Këtu janë disa këshilla përmenaxhimin:

- Mos shërbeni më shumë se 4 kg koncentrate për vakt; -Oferta përqendrohet në disa vakte të vogla në ditë sesa në dy vakte të mëdha, veçanërisht në mot të nxehtë; -Shpërndani suplementin e proteinave pas ose gjatë vaktit të koncentreve; Shërbyer mbushjen 1 ose 1 orë para koncentratit;
- Kombinoni foragjeret (p.sh. para-hajlaj dhe silazhin e prerë direkt) ose ofroni një TMR;

- Siguroni disponueshmërinë e ushqimit në ushqyes ose lugjet pas kohës së qumështit;

- Përshtatni strategjitë e të ushqyerit në sjelljen e të ushqyerit të lopëve;

- Shërbyer ushqimit për disa herë në ditë dhe RTM të paktën dy herë;

- Shpesh e afroni ushqimin më afër lopëve në stalla lidhëse;

- Pastroni lugjet dhe ushqyesit çdo ditë, veçanërisht në mot të nxehtë; Pastruesit e pijshëm dhe pastrimet shpesh;

- Alokoni të paktën 60 cm (2 ft) ushqyes për lopën; Lejoni hyrjen e lopëve për tu ushqyer për të paktën 22 orë në ditë;

- Lopët e shëndetshme dhe të kënaqur hanë më shumë ushqim;

- Prerja e rregullt e thundrës përmirëson lëvizjen e lopës dhe konsumin e ushqimit.

- Kjo fletë teknike paraqet vetëm informacione të përgjithshme mbi formulimin e racioneve.

- Mënyra e vetme për të zhvilluar një program specifik të ushqyerit është të ekuilibroni plotësisht racionet.

- Një shërbim kompjuterik falas për formulimin e racioneve ofrohet nga të gjitha zyrat lokale të MAAO dhe nga Shërbimi i Konsultimit të Kafshimit të Kafshëve, Departamenti i Prodhimit të Kafshëve.

- Disa fletë teknike mund të jenë gjithash-tu të dobishme:

- Si të balanconi racionet e lopës së qumështit, AGDEX 410/52;

- Kërkesat ushqyese për bagëtinë e qumështit, AGDEX 410/53;

- Menaxhimi dhe ushqyerja e lopëve të thata, AGDEX 410/50;

- Vlerësimi i gjendjes së mishit të bagëtive të qumështit, AGDEX 411/10.

BOTIME TË REJA

POET I MALLIT

Nga Istref Haxhillari

Një jetë tepër e bukur, por dhe e vështirë. Plot 42 vjet si gazetar bujqësie, por dhe si realizues i shumë emisioneve dhe filmave dokumentarë për bujqësinë. Ka marë pjesë në disa festivale kombëtare ku ka fituar 3 çmime si dhe ato ndërkombëtare e ka fituar katër çmime. Qysh në rini ishte kryeredaktor i parë i gazetës “Studenti i bujqësisë”. Më pas, vijon në Televizionin Shqiptar, ku ishte redaktor i parë i emisioneve për çështjet e bujqësisë. Më vonë u “ankorua” në



sektorin e filmit pranë Ministrisë së Bujqësisë ku ka ndërruar plot 15 ministra, Pas 42 vitesh punë intensive, e sheh veten në pension, por duke mos hequr dorë kurrë nga gazetaria e filmi dokumentar edhe aty ne Boston ku e ka hedhur era e emigracionit. Pasioni për gazetarinë e mban gjithmonë të ri.

Gazetari dhe kineasti i njohur i Bujqësisë në Televizionin Publik Shqiptar (TVSH) Fuat Memeli, promovoi këtë meshtatori, në Bilisht të Korçës me anëtarë të Klubit “Miq të Dritëroir” si dhe krijues të tjerë librin me poezi “Ujëvarat e mallit”.

(Vijon nga faqja 10)

bënë gjëmën mijëra qytetarëve të pafajshëm. Piramida që ngre Miç, sigurisht që është më e stërholluar, por në thelb ajo sjell të njëjtat pasoja.

Në kohët kur shoqëria jonë vazhdon të jetë tejet e politizuar, shkrimtari Shefqet Meko, me shembullin e Xhelo Lakrorit, sjell një mesazh të thjeshtë e të dobishëm, ta duam politikën, ta kuptojmë politikën, por të mos politizohemi deri në thua,

Gështenjat e Tropojës janë të vetmet gështenja shqiptare që përmbushin plotësisht cilësimin e kërkuar për eksport në Itali dhe vende të tjera të Bashkimit Evropian. Studime të shumta kanë treguar se gështenjat e kësaj zone janë më të mëdha dhe më të ëmbla se gështenjat e tjera lokale.

Dhe po t’u shtosh dhe pyjet natyrale, prodhimin natyralisht organik dhe freskia e Alpeve ku ato rriten, padiskutim i bën ato akoma më unike në shije.

Gështenja e Tropojës ajo që kryeson eksportin, duke qenë gështenja e vetme shqiptare që përmbush kriteret e cilësisë për t’u eksportuar në BE.

Sipas tregtarëve të pyetur nga AgroWeb.org, kërkesa ndërkombëtare për gështenja me cilësi të lartë ka qenë në rritje që prej gjysmës së dytë të viteve 1990, pjesërisht edhe për shkak të interesit në rritje të konsumat

Pasi lexova poezitë prekëse të vëllimit të fundit poetik të Fuat Memellit “Ujëvarat e mallit”, munda ta shkruaj menjëherë, për një arsye të thjeshtë. E gjeta veten zhytur vargjeve ku gëlon malli për njerëz e vende aq të ngjashme me ato të miat. Çuditërisht vargjet patën ndikim të madh personal. E imagjinova veten bujtës në visoret ku janë thurur poezitë, takova pleq të mocëm dhe të rinj me mendësi amerikane, miq të shtrenjtë që prej kohësh i shihja vetëm në ëndërr, ndjeva gurgullimën e dëborës së shkrire pranverës dhe penelat e vjeshtës mengjyra të ndezura përgjatë rrjedhës së lumenjve. Në poezinë “Ujëvarat e mallit” nga ka marë edhe titullin vëllimi, ndër të tjera poeti thotë:

Vijnë ato nga rrugë e gjatë
E derdhen në shpirtin tim
T’i bëj pritë, s’jam i aftë
Janë ujëvara nga vendi im.

Bëj t’i zbut me ndonjë varg
Sa t’ua ul pakëz vrullin
Por ato më vijnë prap’
Në mendime prap’më futin.

Nëse do të kërkonim pak fjalë për të përkufizuar të veçantën e poetit Fuat Memelli, do të ishte pa dyshim grupi emëror “Poet i mallit”. Ky përcaktim i shkon për shtat

profilin të tij poetik, që edhe pse nuk është posaçërisht i kësaj linje, të shkruarit e vargjeve e ka dhunti. Poezia e Memellit është dehëse, ritmi melodioz, tematika shpërthim ndjenjash të ngrohta. Larmi figurash letrare të cilat autori i ndërton me finesë, duke përcjellë te lexuesi mendim të thellë e të ngjeshur



Një kujtim pas promovimit në Bilisht, me anëtarë të Klubit “Miq të Dritëroir” si dhe krijues të tjerë.

që të freskon si psherëtimë ere Devolli.

Një grusht ujë te burimi
Më i mirë se çfarëdo pije,
Këngë magjie nga bilbili
Melodi, çfarë melodie!

Poezitë e punuar me elegancë krijojnë te lexuesi imazhe që nuk zhduken lehtë. Fuat Memelli është poet i ndjesive të ngrohta dhe situatave befasuese, përftuar më së shumti nga përvoja e vet. Në pamje të parë duket sikur vargjet janë të rrafshit personal, por jo. Ato shtrihen më gjerë,

kanë përmasa sociale gjithë kohore. Vizioni i poetit është i thellë. Shkruan për dashurinë njerëzore në kuptim global, prindërit, familjen, gruan, fëmijët, shokët e miqtë, për të ikurit në amshim, vendlindjen,

mërgimin, duke ngjizur vargje që të drithërojnë shpirtin.

Pragun ku linda dua të shkel,
Gjurmët e prindërve t’i prek
Të hyj aty, ku shpirti çel
Ku flad i mallit, pas më ndjek.

E për një këngë, më merr malli
Në sofër burrash ta dëgjoj
Një gotë raki, ballë kazani
Me miq e shokë ta shijoj.

Poeti nuk ngutet, as nxihet, anipse vargjet mund të konturohet në një çast të vetëm, ato skaliten me merak e përkujdesje si gurskalitësit e vendit të vet. Edhe kur kanë të njëjtin motiv nuk i ngjajnë njëra-tjetrës, secila poezi ka tharmin e vet të papërsëritshëm. Ato e

Rrathët e jetës shtohen një nga një
Ashtu si te drurët, moshën tregojnë
Vjen një ditë, për rrathët s’ka vend më
Drurët dhe njerëzit “lamtumirë” na thonë.

Rrathët e drurëve, që t’i numërojmë
Trup i tyre do sharruar
Rrathët tona, vërtet s’i shikojmë
Në rrudha e flokë, janë të shkruar.

befasojnë lexuesin për fjalorin e larmishëm, të thjeshtë e poetik, stilistikën e përzgjedhur me masë në funksion të ideve dhe mesazheve që përcjell. Në vargjet e këtij vëllimi plot ndjenjë e përkushtim, vendin kryesor e zë poezia meditative që buron nga pejzat më të thella të shpirtit. Objekt i med-

itimit është njeriu, vendi i tij, Bostoni ku jeton prej vitesh, por edhe një pemë e vetmuar, bregu i lumit, apo një mulli i vjetër, i harruar diku.

Jetim ai ka mbetur
I ngjet një bote tjetër
Ka vite që rri dergjur
Mulliri ynë i vjetër.

Të heshtur gurët rrinë
Mbledhur të dy tok
Më ngjan sikur ngrijnë
Veç qielli i mbulon.

Poezitë e këtij vëllimi të shkruara këto vitet e fundit, në mënyrë paksa të të heshtur e joshin lexuesin, e bëjnë më të ndjeshëm e më të mirë gjatë shtegimit në hapësirat lirike, ku i shpie natyrshëm Fuat Memelli. Është libër i poezive që duhet lexuar dhe rilexuar ngadalë, duke u kënaqur me secilin varg dhe duke kërkuar

bashkë komunikim të thukët njerëzor.

Pasi e përfundon leximin, pasi merr frymë thellë, bindesh se më e spikatura e këtij vëllimi poetik është malli i njeriut që me kalimin e moshës bëhet më i thellë se deti dhe më i rrëmbyeshëm se lumenjtë në pranverë.

para lexuesit sa më parë romanin e radhës. Nëse miku i tij, shkrimtari dhe poeti i talentuar, Ahmet Prençi, e shkundi dhe e motivoi për të shkruar këtë roman, vetë “Saga përtej Atlantikut” tani është më shumë se motivim, për të mos e ndërprerë krijimtarinë. Rikthimi në Tiranë pas 10 vitesh i Shefqet Mekos, ngjason me rikthimin e tij në fushën e letërsisë pas 20 vitesh. Në rastin e Shefqetit, rikthimi shpirtëror (ardhja në atdhe) dhe letrar (romani) kanë ushqyer njëri – tjetrin.

Që nga klima e favorshme tek kushtet e tokës, fitimi i lartë, kërkesa e papërmbushur e tregut ndërkombëtar dhe duke qenë se nuk kërkon shumë marketing dhe kërkesa për ruajtje. Përvoja e fundit dhe rritja e shpejtë e drurëve frutorë tregojnë se fermerët shqiptarë janë të etur dhe të shpejtë në adoptimin e teknologjive moderne të prodhimit.

Në të njëjtën kohë kosto e punës është shumë e ulët duke krijuar një avantazh në këtë aspekt.

Nga ana tjetër afërsia e Shqipërisë me Bashkimin Evropian dhe procesi i saj i anëtarësimit për t’u bërë anëtare e BE gjithashtu ofrojnë avantazhe të shumta.

Që nga klima e ulët e transportit dhe regjimit tarifor preferencial për të gjithë prodhimet shqiptare të eksportuara në BE, duke bërë që ato të jenë konkurruese në treg./AgroWeb.org

“Saga përtej Atlantikut” - Promovohet libri i Shefqet Mekos, reflektim mbi çështjet që përballet shoqëria shqiptare

aq sa të harrojmë detyrat tona bazë, aq sa të harrojmë vetë familjet tona! Edhe Xhelo Lakrori ra viktimë e politizimit të tij në një moment të caktuar, kur nuk kuptoi rolin dhe vendin që ai realisht zinte në shoqëri.

Duke mos zbuluar para lexuesit shumë surpriza dhe elementë të tjerë që e bëjnë këtë

roman unik në përmbajtjen dhe stilin e tij, dua të shënoj këtu se “Saga përtej Atlantikut”, vjen gjithashtu si një risi letrare për kohën tonë.

Ky roman, së bashku me “Metamorfoza e një Kryeqyteti” të Ylljet Aliçës, “Dëmtuar gjatë rrugës” të Besnik Mustafajt dhe ndonjë tjetër, pasuron fondin e

prozës moderne të shkruar në stilin e satirës dhe sarkazmës. Duhet shumë eksperiencë letrare dhe një mprehe shumë e hollë e lapsit krijues për të shkruar vepra të tilla, ku satirizimi mban gjallë frymën dhe ritmin e romanit. Besoj se Meko e ka kaluar këtë sprovë me sukses dhe ai duhet të vazhdojë në këtë

lëmi për ta përsosur më tej këtë stil të veçantë krijues. Edhe pse ky është romani i parë i botuar i Shefqet Mekos, niveli i tij tregon për një pjekuri të lartë artistike të autorit. Unë e inkurajoj shkrimtarin Shefqet Meko që, pavarësisht angazhimeve të përditshme të jetës amerikane, të vijojë krijimtarinë e tij letrare që të sjellë

Krenaria shqiptare - Ja pse gështenjat e Tropojës janë super të kërkuara në Evropë

torëve.

Cilat vende i kërkojnë me ngulm Gështenjat e Tropojës?

Gati e gjithë sasia e mbledhur nga Masivi i Pyjeve të Gështenjave të Tropojës shkon për eksport, ku kryeson Italia dhe vende të tjera të Bashkimit Evropian.

Në tregun e huaj gështenjat shqiptare shiten disa fish më shtrenjtë se në vend duke sjellë një tkurrje të plotë të pranisë së këtyre gështenjave në tregun shqiptar.

Në Shqipëri prej disa vitesh funksionojnë pesë kompani që mbledhin gështenja për eksport drejt tregjeve të huaja.

Kërkesa e tregut vendas mbetet e lartë dhe kjo tregon mundësi për zhvillim të gështenjave shqiptare për eksport,

por sidomos për të përmbushur nevojat e tregut të brendshëm.

Gështenjat shqiptare në pjesën më të madhe gjenden në anë të maleve dhe kodrave në Kolgecaj dhe Lekbibaj në



Tropojë, në Shënmëri në Kukës, Mes dhe Shllak në Shkodër, Kashnjet në Lezhë, Shupal në Tiranë, në Pogradec, në Muzinë në Delvinë, Dhrovjan dhe Lesh-

nicë në Sarandë.

Ndërkohë që edhe zona të tjera si Berati, Skrapari, Përmeti, Gramshi dhe Tepelena e kultivojnë gështenjën, por në sasi më të vogla në një sipërfaqe to-

tale prej 8000 ha.

AgroWeb.org raporton se brenda këtyre sipërfaqeve ka me qindra hektarë që mund të mbillen me gështenja, duke

rritur kështu në mënyrë të madhe numrin ekzistues. Kjo për të përmbushur urinë e tregut evropian dhe duke i dhënë një shtysë të fortë ekonomisë së këtyre zonave që mbajnë familjet nga shitja e tyre.

Por sidomos masivi i gështenjave të Tropojës ka nevojë të vazhdueshme për mirëmbajtje, mbështetje me teknikë dhe ndihmesë direkte për të siguruar vazhdimësinë e këtij produkti kaq të kërkuar nga tregjet e BE-së.

Pse arrorët janë një mundësi e artë për rritje ekonomike?

AgroWeb.org raporton se përgjithësisht sektori i arrorëve (arrat, lajthitë, gështenjat dhe bajamet) shihet si një sektor me potencial të lartë për eksport për shkak të shumë avantazheve.

KËNDI I EKSPERTIT

Shumë bimë të rritura në mënyrë spontane në natyrë të cilat ne deri tani i kemi konsideruar si bimë të egra dhe të padobishme, kanë filluar të marrin rëndësi për dietën ushqimore të njeriut dhe të kërkohen mjaft në treg dhe në zinxhirin e konsumit. Një nga këto bimë është dhe rrodhja e madhe.

Rrodhja e madhe (*Arctium lappa*) është një bimë e egër që bën pjesë në gjininë *Arctium* të familjes së luledielliit (*Asteraceae*). Rrodhja është një bimë barishtore dyvjeçare me origjinë nga Europa dhe Azia dhe disa specie të kësaj gjinie janë të përhapura në të gjithë Botën. Sot ajo ka filluar të kultivohet si bimë perimore në kopshte duke përdorur rrënjët e saj për gatime të ndryshme. Kjo bimë tek ne gjendet sponatnisht në toka djerrë dhe ugare, nëpër shkurre e pyje, anës rrugëve dhe hendejëve etj.

Kjo specie është vendëse në rajonet e butë të Botës së Vjetër, nga Skandinavia në Mesdhe dhe nga Ishujt Britanikë përmes Rusisë dhe Lindjes

dhe merr trajtën e një kaçubeje. Bima ka gjethe të mëdha, të vendosura në mënyrë të alternuara në kërcell, gjethet janë me formë vezake dhe me buzë të dhëmbëzuara rrallë, që kanë një bisht të gjatë dhe janë me një push në ngjyrë gri në anën e poshtme të tyre. Bimët e gjinisë *Arctium* kanë gjethe jeshile të errëta që mund të rriten deri në 70 cm. Ato janë përgjithësisht të mëdha, të trasha dhe ovale, ndërsa gjethet e poshtme janë në formë zemre. Bishtat e gjethëve janë përgjithësisht të zbrazëta. Gjethet e rodheve të mëdha shërbejnë si ushqim për vëmjet e disa Lepidopterave,

Rrënjët e rrodhes, janë bosh-tore por mjaft të degëzuara, me ngjyrë krem, me diametër deri 1-2 cm dhe gjatësi që shkon nga 20-30 cm dhe shkojnë deri në thellësinë 1 metër në tokë. Rrënjët janë tulore dhe përdoren si ushqim nga shumë lloje

Braktet që mbështjellin lulet kanë maja gjëmbore si gremç dhe ngjiten shumë lehtë në rrobat e njerzve ose trupin e kafshëve, sidomos atyre me lesh si delet, dhitë e tjera. Lulet e rrodhes së madhe japin pollen dhe nektarin thelbësor për bletët gjatë muajit gusht kur trifili dhe bimët e tjera janë në rënie dhe para fillimit të lulëzimit të luleve të tjera mjaltëse.

Frutat janë akena, ato janë të gjata, të ngjeshura, me qime të shkurtra në bazën e tyre. Çdo frut përmban një farë me formë gjatësore dhe ngjyrë krem, me lëvore të lëmuar.

Bima në vitin e parë të vegjetacionit të saj formon një rozetë të fuqishme me gjethe të mëdha dhe me bishta të shkurtër dhe sistemin rrënjor boshtor. Në vitin e dytë ajo nxjerr kërcëjtë lulorë dhe formon lulet dhe farat.

Rrodhja e madhe është

njihet si niúbàng; në Japoni ku njihet si gobo dhe në Kore ku njihet si ueong dhe konsumohet gjerësisht në rajon. Ajo është përdorur në Evropë gjatë Mesjetës si një perime, por tani përdoret rrallë përveç në Itali,

tyre të holla, të cilat mund të rriten rreth 1 metër të gjata dhe 2 cm të trasha. Rrënja është përdorur tradicionalisht në Britani si një pije luleradhique dhe rodhe, e cila ende prodhohet komercialisht.

taninë-hekuri. Këto polifenole janë derivate të acidit kafeoilkinik.

Rrënjët e Rrodhes së Madhe përmbajnë rrëshira, përbërës të acetilenit sulfurik, poliacetilene dhe përbërës të hidhur të tipit guaianolid. Farat e rrodhes përmbajnë arctigenin, arctiin dhe polifenole butyrolactone. Vlerat ushqimore të rrodhes së madhe paraqiten në pasqyrën e mëposhtme.

Vlera ushqyese e rrënjëve të Rrodhes së Madhe (për 100 g lëndë e freskët)

Treguesit	Sasia	Në % të nevojave ditore të njeriut
Energjia	302 kJ (72 kcal)	
Karbohidrate	17.34 g	
Sheqer	2.9	
Fibra Dietike	3.3 g	
Yndyrë	0.15 g	
Proteina	1.53 g	
Vitamina		
Thiaminë (B1)	0.01 mg	1%
Riboflavinë (B2)	0.03 mg	3%
Niacinë (B3)	0.3 mg	2%
Acid Pantotenik (B5)	0.321 mg	6%
Vitaminë B6	0.24 mg	18%
Folate (B9)	23 µg	6%
Vitaminë C	3 mg	4%
Vitaminë E	0.38 mg	3%
Vitaminë K	1.6 µg	2%
Minerale		
Kalcium	41 mg	4%
Hekur	0.8 mg	6%
Magnezium	38 mg	11%
Manganez	0.232 mg	11%
Fosfor	51 mg	7%
Potas	308 mg	7%
Natrium	5 mg	0%
Zink	0.33 mg	3%



Bima e Rrodhes e madhe (*Arctium lappa*) ne vitin e pare (1) dhe vitin e dyte (2) te vegjetacionit

së Mesme në Indi, Kinë, Tajvan dhe Japoni. Kjo gjini është natyralizuar pothuajse kudo dhe zakonisht gjendet në zonat e ashpra, veçanërisht në toka të pasura me azot.

Rrodhja e madhe është një bimë dyvjeçare, me lartësi të bimës që shkon zakonisht deri 1 m lartësi por ka dhe raste kur bimët arrijnë lartësi të madhe duke arritur deri në 3 m lartësi

lepidopterësh. Ato shërbejnë si ushqim për njerzit dhe për receta të ndryshme mjekësore për shërimin e disa sëmundjeve tek njeriu.

Llojet e *Arctium* zakonisht lulëzojnë nga korriku deri në tetor. Lulëria është një vile që përbëhet nga kaptina (kokë) të rrumbullakta, të mëdha me diametër deri 4 cm, me bishta të gjatë të renditur në vastakë.

bimë spontane që rritet lirisht në natyrë. Por kohët e fundit ka filluar dhe kultivimi i saj nga fermerët në vënde të ndryshme sidomos në Azi, në vënde të tilla si Kina, Japonia etj., ku ka filluar të zërë një vend të rëndësishëm në kuzhinën e këtyre vendeve.


Rrënja e Rrodhes së madhe tani përdoret gjerësisht si ushqim për njerzit në Kinë ku

Brazil dhe Portugali, ku njihet si bardana ose “garduna”. Bimët kultivohen për rrënjët e

Rrënja është shumë e brishtë dhe ka një shije të ëmbël, të butë dhe djegëse me një ashpërsi të vogël që mund të reduktohet duke njomur rrënjët e grira ose të copëtuara në ujë për pesë deri në dhjetë minuta. Gjithashtu mund të përdoren dhe kërcëjtë e njomë të luleve që mund të vilen vonë në pranverë, para se të shfaqen lulet. Shija e tyre i ngjan asaj të angjinares me të cilën bima e rodhes ka afërsi botanike.

Në gjysmën e dytë të shekullit të 20-të, rodhja arriti njohjen ndërkombëtare për përdorimin e saj të kuzhinës për shkak të popullaritetit në rritje të dietës makrobiotike, e cila propagandon konsumin e saj. Rrënja përmban një sasi të mirë të fibrave dietike, kalcium, kalium, aminoacidet dhe ka fuqi kalorifike të ulët. Ajo përmban polifenole që shkaktojnë errësimin e sipërfaqes dhe ka ashpërsi të butë si rezultat i formimit të komplekseve

Në kuzhinën japoneze, rrodhja e madhe përdoret gjerësisht në përgatitjen e gatimeve të ndryshme. Në Japoni Rrodhja e madhe (*Arctium lappa*) është e njohur si Gobo dhe është përdorur si ushqim për rreth 1.000 vjet pasi murgjit budistë e sollën bimën në këtë vend. Një pjatë popullore japoneze është kinpira gobo, që përgatitet nga rrënjët e rodheve të grira ose të copëtuara, duke i zjerë me ngadalë në salcë soje, sheqer, mirin ose sake (pije japoneze) dhe vaj susami. Një gatim tjetër është Rrodhe makizushi, sushi i mbështjellë, i mbushur me rrënjë rrodhe turshi. Rrënja e rodheve shpesh ngjyhet me ngjyrë portokalli me ngjyresë artificiale që i ngjan një karrote. Rrënja e rrodhes gjithashtu mund të gjendet si një meze (snack) e skuqur që është e ngjashme me shijen dhe cilësinë e patateve të skuqura dhe që



Sistemi rrenjor i Rrodhes se Madhe

KËNDI I EKSPERTIT

Rrodhja, një bimë me vlera ushqyese dhe mjekësore

(Vijon nga faqja 14)



Rrenjet e Rrodhes se Madhe

përdoret herë pas here si një përbërës në gatimet tempura që është një pjatë japoneze zakonisht e përbërë nga ushqim deti ose perime që janë rrahur shumë dhe skuqur thellë.

Përveç kësaj rrënjët e rrodhes mund të përgatiten në mënyra të ndryshme, të tilla si:

- Sallata të ndryshme,
- Përzierje me skuqje: rrënja mund të shtohet në perime të skuqura për t'u dhënë aromë dhe lëndë ushqyese shtesë,
- Të freskëta: rrënja e rrodhes mund të hahet e papërpunuar për një rostitjeri të shpejtë dhe ushqyes. Sigurohuni që ta pastroni atë tërësisht së pari dhe të spërkatni me pak kripë për shije.
- Supë: rrënjët mund të përdoren si përbërës për supë me perime,
- Turshi: rrënjët e rrodhes mund të marinohen në uthull musht molle për të ruajtur jetëgjatësinë e saj në rafte. Shtimi i barërave të tjera dhe erëzave në përzierje mund t'i japë më shumë lëndë ushqyese dhe aromë.

Në Japoni përdoret gjithashtu fermentimi i rrënjës së rrodhes me anë të majasë nga


orizi në kuzhinën japoneze.

Një pije e gazuar Qumësh-tore dhe Rrodhe është një pije që konsumohet në Ishujt Britanikë që nga Mesjeta. Ajo ishte fillimisht një lloj i lehtë mead, por me kalimin e viteve ka evoluar në pije të gazuara që janë në dispozicion komercial edhe sot. Tradicionalisht kjo pije është bërë nga rrënjët e luleradhiqes (Taraxacum officinale) dhe rrodhes (Arctium lappa), të fermentuara. Të dyja bimët mendohet se janë të dobishme për funksionimin e shëndetshëm të mëlçisë.

Rrodhja e madhe përdoret dhe si bimë medicinale dhe aromatike

Për këtë qëllim përdoren rrënjët e thara të bimës. Kur rrënjët e thara të rrodhes mbahen në vende të thata dhe të ajrosura mirë, ruajnë veprimin e tyre për 18 muaj.

Qysh para 1000 vjetësh, kur murgjit budistë e shpunë këtë bimë në Japoni, ata përdorën rrënjët e saj për të kuruar sëmundje të tilla si kapsllëku dhe helmimi me zhivë dhe gjethet përdorëshin për të shëruar skuqjen dhe djegiet.



Sallatë japoneze "Gobō salad" me rrënjët e Rrodhes së Madhe

Aspergillus oryzae e cila përdoret gjithashtu për të bërë miso (një kondiment tradicional japonez që prodhohet nga fermentimi i sojës dhe disa drithrave të tjera) dhe verë

Sot shumë japonezë si dhe evropianët përdorin Arctium si ushqim dhe ilaçe. Në Evropë gjatë luftërave botërore Arctium u përdor si një trajtim për plagët. Pelegrinët e shpu-



Pija Qumesh-tore dhe Rrodhe



Gatimi japonez Kinpira Gobo

në rrodhen e madhe Arctium lappa në Amerikën e Veriut dhe amerikanët vendas shpejt e shtuan bimën në repertorët e tyre bimore për aftësitë e saj të pastrimit të gjakut, si një tonik i veshkave dhe gjithashtu për të rritur përqendrimin. Ajo gjithashtu është përdorur historikisht për të trajtuar humbjen e flokëve. Në herbalizmin perëndimor, rrodhe është një barishte e rëndësishme alternative dhe është përdorur si një agjent detoksifikues për të "pastruar" gjakun, duke hequr toksinat nga trupi. Përdoret si nga brenda ashtu edhe nga jashtë për shumë kushte të lëkurës, të tilla si puçrra fytyre, akne, abscese dhe ekzema dhe për situata të inflamacionit kronik, si reumatizmi dhe përdhësi.

Rrënjët e thara të rrodhes (Bardanae radix) përdoren në mjekësinë popullore si një diuretik, diaforetik dhe si një agjent që pastron gjakun.

Në sajë të mucaligjeve, essences, taninave, substancave minerale, glukozidit arciinë, substancave fitoncide etj. rrodhja përmirëson çrregullimet e aparatit tretës, forcon qëndrueshmërinë e organizmit ndaj sëmundjeve dhe shton urinimin. Rrënjët e Rrodhes së madhe këshillohen si mjet diuretik i lehtë në sëmundje që shoqërohen me mbajtjen e urines në organizëm. Rrodhja këshillohet dhe si mjet forcues në periudhat pas sëmundjeve të rënda dhe në lodhjet pranverore. Kohët e fundit kjo bimë po përdoret si mjet ndihmës kundër diabetit.

Rrënjët e rrodhes së madhe përdoren jo vetëm nga brenda por dhe jashtë, për mjekimin e sëmundjeve të lëkurës, ekzemes, proceseve të qelbëzuara, plagëve që shërohen me vështirësi dhe kundër zbokthit të lëkurës së flokëve.

Nga disa të dhëna anekdo-

tike të shekullit të 19-të del se rrodhja e madhe si bimë medicinale është përdorur gjithashtu nga fisi Ojibwa (që jetonte në SHBA dhe Kanada) dhe sot, në formë të përbërësit të çajit Essiac për trajtimin alternativ të disa kancerëve.

Si një vaj zbutës rrënja e rrodhes është një komponent i disa produkteve kozmetike, shampove dhe produkteve të kujdesit të flokëve.

Farat e rrodhes së madhe janë përdorur në mjekësinë tradicionale kineze veçanërisht për mirëmbajtjen e lëkurës dhe në formulat e të ftohtit dhe gripit, nën emrin niubangzi.

Recetat për përdorimin e rrënjëve të Rrodhes së madhe janë të ndryshme. Kështu për përdorim të brendshëm, mund të përgatitet një recetë e tillë:

1 lugë çaji me rrënjë të grimcuar të rrodhes hidhen në një enë ku shtohet 1 filxhan çaji me ujë, përmbajtja vihet në zjerje për 10-15 minuta, pastaj lihet të ftohet dhe në fund lëngu kullohet dhe pihet (i ëmbëlsuar ose jo sipas dëshirës). Zakonisht merren 2-3 filxhanë çaji në ditë.

Bari mund të përdoret dhe në formë pluhuri duke marrë 3 herë në ditë nga 2-3 gram.

Për përdorim të jashtëm, çaji përgatitet si më sipër, por duke përdorur 2 herë më shumë sasi bari.

Për përdorim të brendshëm mund të përdoren dhe këto receta:

Rrënjë të thatë: 2-6 g rrënjë të thata, ose të zjerra, tri herë në ditë

Ekstrakt i lëngët: (1:1 në alkool 25%): 2-6 ml tri herë në ditë

Tinkturë: (1:10 në 45% alkool): 8-12 ml tri herë në ditë

Zierje: 1 pjesë në 20, 500 ml në ditë

Për përdorim të jashtëm: Një infuzion ose tinkturë (1: 5 në 25 % alkool) të gjetheve

mund të përdoret nga jashtë si një llaça.

Me rrënjët e Rrodhes së madhe përgatiten çajra të ndryshëm. Për këtë qëllim veprohet si më poshtë:

Përbërësit: Një rrënjë rrodhe dhe 2 litra ujë (pak më shumë se 2 litra)

Procedura:

1. Duke përdorur një leckë pastrimi, largojmë nga rrënja papastërtitë e mbetura duke e mbajtur rrënjën nën ujë të rrjedhshëm. Më pas, pritet rrënja në feta të holla. Lëkura e rrënjës nuk zhvishet, sepse aty gjendet shumica e lëndëve ushqyese.

2. Vendosen fatet e prera në një enë të cekët dhe mbulohen me një copë bezeje. Vendoset ena në një vend me diell për një deri në dy ditë derisa fatet të jenë të thata dhe të buta. Kur nuk lejojnë kushtet e motit mund të përdoret një dehidrator.

3. Vendosen fatet e thata në një tigan. Vendoset tigani nën nxehtësi të ulët, duke trazuar fatet për 10 minuta derisa të marrin ngjyrë kafe të artë, të brishta dhe të lëshojnë aromë të mirë.

4. Lihen fatet të ftohen për 10 deri në 15 minuta. Për të ruajtur ato, përdoret një enë hermetike për të parandaluar futjen e lagështirës.

5. Ziejmë ujin në një tenxhere, pastaj shtohen 10 gramë feta të thara të rrodhes. Lëreni zierjen e çajit për 10 minuta. Pastaj ftohet dhe pihet.

Kur dëshirohet të pihet vetëm një filxhan, përdoren vetëm pesë deri në tetë feta rrënjë të cilat hidhen në ujë të nxehtë dhe lihen duke i përzierë për 5 minuta para se të pihet.

Kur nuk ju pëlqen shija e çajit të rodheve, mund të shtohet mjaltë i freskët, krizantemë, manaferra ose gjethe nenexhik për të përmirësuar shijen.

Rrënjët e Rrodhes së madhe mund të përdoren si një vaj esencial

Përveç përdorimit të saj të kuzhinës, rrënja e rrodhes mund të përdoret dhe si një vaj esencial, me përfitime të lidhura kryesisht me lëkurën dhe lëkurën e kokës.

Ajo që e bën më të mirë vajin e rrënjëve të rrodhes është se ai mund të përgatitet lehtë në kushtet shtëpiake. Për të bërë infuzionin e rrënjëve të rrodhes nevojiten disa rrënjë të thata të bimës, vaj ulliri ekstra të virgjër dhe një kavanoz qelqi steril. Për këtë veprohet si më poshtë:

1. Priten rrënjët në copa të vogla, pastaj ato goditen lehtë me një çekik.

2. Vendosen rrënjët në kavanoz dhe pastaj shtohet vaji i ullirit. Sasia varet sipas dëshirës dhe sasisë së vajit që do të përgatitet.

3. Vendoset kavanozi në një vend të errët për gjashtë javë për të lejuar që vaji të absorbojë lëndët ushqyese të rrënjëve.

4. Hapet kavanozi një herë në javë për të lirufluskat e ajrit që mund të krijohen eventualisht.

5. Pasi përzierja mbush gjashtë javë që është vendosur, kullohet dhe mund të përdoret.

Përfitimet e vajit të rrënjëve të rrodhes janë kryesisht më të njohur për lëkurën dhe përfitimet e flokëve. Vaji përmban vitaminë A dhe acide të ndryshme yndyrore esenciale, të cilat ndihmojnë në ushqimin e lëkurës së kokës dhe nxisin rritjen e shëndetshme të flokëve. Vaji i rrënjëve të rrodhes gjithashtu mund të sigurojë lehtësim nga infeksionet dhe irritimet e shkaktuara nga zbokthi, pasi ajo ndihmon në mbajtjen në gjendje të shëndetshme të gjëndrave dhjamore dhe folikulave të flokëve.

Përveç rritjes së saj në natyrë, rrodhja e madhe mund të kultivohet dhe në kopshte pranë shtëpive.

Rritja e rodhes në kopshte pranë shtëpisë është mjaft e lehtë, pasi ajo mund të rritet në mjedise të ndryshme me shumë pak probleme. Me kujdesin dhe mirëmbajtjen e duhur, mund të merret një prodhim me cilësi të lartë.

Gjatë kultivimit të saj duhen mbajtur parasysh që kjo bimë preferon një tokë të freskët, të punuar mirë, të pasur me humus dhe duhet të jetë i pozicionuar në dritën e diellit të plotë. Rrodhja është shumë e ndjeshme për plehrat e azotit. Kultivimi i kësaj bime bëhet përmes mbjelljes së farave në tokë mes të verës. Vjelja e bimëve kryhet pas tre deri në katër muaj pas mbjelljes deri në vjeshtën e vonë, kur rrënjët bëhen shumë fibroze.

Përgatitja e tokës dhe farërave. Toka duhet të jetë e shkrifët dhe pjellore me një nivel pH neutrale dhe me lagështi mesatare. Para mbjelljes farat vendosen në ujë për një natë për t'i ndihmuar ato të mbijnë më shpejt.

Mbjellja e farërave. Farat përhapen lehtë mbi shtratin e përgatitur në kopsht sapo të kalojnë ngricat e fundit në pranverë. Më pas, farat mbulohen me dhe të shkrifët të imët në thellësi 1.5 – 2 cm. Pas mbjelljes toka ngjishet pak në shtresën e sipërme dhe pastaj ujitet lehtë me ujë.

Vjelja dhe ruajtja e rrënjëve. Farat mund të mbijnë vetëm pas katër deri në shtatë ditë. Sapo të shfaqen bimët dhe të rriten disa centimetra, bimët rrallohen duke i lënë në distance 8 x 5 cm. Shërbimet e mëtejshme konsistojnë në shkriftimin e tokës dhe ujitjet. Pas rreth tetë deri në 12 javë, do të jenë formuar rrënjët e rodhes. Për të marrë rrënjët e bimës përdoren lopata ose një pirun kopshti. Për cilësinë më të mirë, zgjidhen rrënjët sapo të arrijnë një gjatësi prej 30-60 cm.

Rrënjët konsumohen të freskëta ose ato gjithashtu mund të vendosen për t'u tharë në vende të hijezuara në mënyrë që të qëndrojnë për një kohë të gjatë.

KREDI PËR ÇDO SIPERMARRËS

KREDI E SHPEJTË ME NORMA KONKURRUESE

deri në
7 MILIONË
Lekë



FED
invest 

**GJITHMONË
FINANCË SOCIALE**